



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2026

**VENDIM**  
**Nr. 216, datë 22.04.2026**

**PËR**  
**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT SOKOL SHEHU,**  
**PËR PERIUdhËN 2020 - 2022**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85, 89 dhe 95, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit Sokol Shehu, për periudhën 2020-2022”, i hartuar nga relatore znj. Gentiana Muçaj,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional i gjyqtarit Sokol Shehu, për periudhën 2020-2022”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
  - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
  - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.  
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

---

# ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

---

## 1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.*

### 1.A. Njohuritë ligjore

#### *1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave*

Roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, të cilët do të përcaktojnë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë, edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e çështjes. Në vijim, analizohet mënyra se si janë evidentuar këta elementë ligjor në vendimet burim vlerësimi për gjyqtarin Sokol Shehu.

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:*

#### *- Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes*

Referuar vendimeve burim vlerësimi, konstatohet se gjyqtari paraqet faktet dhe rrethanat e çështjes në përputhje me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Fakti juridik penal paraqitet gjithmonë i ndërthurur me provat e administruara. Nga analiza e mënyrës së inkorporimit të rrethanave të çështjes në vendimet objekt shqyrtimi, pavarësisht natyrës së tyre (*gjykim penal themeli, seancë paraprake apo kërkesë penale*), si dhe llojit të gjykimit (*i zakonshëm apo i shkurtuar*), evidentohet se gjyqtari i kushton një vëmendje të veçantë përshkrimit të detajuar dhe analitik të fakteve, si atyre me karakter procedural, ashtu edhe atyre që lidhen me themelin e çështjes, duke i parashtruar ato përkatësisht në pjesën e parë dhe të dytë të arsytimit të vendimit.

Në vendimet e analizuara, rrethanat që lidhen me ecurinë procedurale të gjykimit analizohen në pjesën hyrëse të arsytimit, ku gjyqtari vlerëson elementët proceduralë që lidhen me: (i) juridiksionin dhe kompetencën lëndore e tokësore; (ii) kërkesat procedurale të palëve, siç janë kërkesat për gjykim të shkurtuar; (iii) vendimmarrjet e ndërmjetme,

përfshirë pezullimin e gjykimit në rastet kur i pandehuri nuk gjendet apo nuk ka dijeni për procesin; si dhe (iv) aspekte të tjera procedurale që lidhen me seancën paraprake, njoftimin dhe pjesëmarrjen e palëve. Në çështjet e seancës paraprake, gjyqtari përshkruan ecurinë procedurale të çështjeve sa i përket njoftimit dhe pjesëmarrjes së palëve në seancë, sipas parashikimeve të K.Pr.Penale, si dhe të drejtave procedurale të tyre, shqyrtimin e fakteve lidhur me pavlefshmërinë e akteve apo papërdorshmërinë e provave, në rastet e kërkesave për dërgimin e çështjes në gjyq, si dhe vlerësimin lidhur me aspektet procedurale të paraqitjes së kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar.

Pas përshkimit dhe analizës së fakteve me natyrë procedurale, gjyqtari parashtron dhe analizon në mënyrë të detajuar faktet thelbësore të çështjes, duke i paraqitur ato në mënyrë të qartë, në një rend logjik dhe duke integruar në përmbajtje të faktit, provat përkatëse të analizuara në raport me njëra tjetrën, mbi të cilat gjyqtari ka konkluduar lidhur me faktet konkrete. Në disa vendime vihet re se përshkrimi i fakteve nuk paraqitet gjithmonë si një përmbledhje e integruar e provave, por përmes citimit të drejtpërdrejtë të përmbajtjes së tyre (*në rastin e dëshmive, aktet e ekspertimit*).<sup>1</sup> Megjithatë, në këto raste, kur provat, për shkak të volumit apo rëndësisë së tyre, janë cituar pjesërisht, citimin vjen në funksion të analizës së tyre dhe përcaktimit të fakteve, të cilat deduktohen si pasojë e analizës së provave.

**- Lidhur me identifikimin e natyrës së çështjes**

Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i faktit juridik, gjykata krijon idenë e saj rreth natyrës së marrëdhënies juridike për shkak të së cilës çështja i është paraqitur gjykatës për shqyrtim. Në rastin konkret, të gjitha vendimet burim vlerësimi i përkasin natyrës penale të çështjeve. Gjyqtari, pas përcaktimit të natyrës së çështjes, përcakton drejt llojin dhe figurën e veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri, ndërsa në rastet e çështjeve të seancës paraprake, ku objekti i shqyrtimit rezulton të përcaktohet që në pjesën hyrëse të arsyetimit, orienton edhe natyrën e procedimit të zhvilluar, si dhe faktet që do të jenë objekt vlerësimi në vijim të arsyetimit. Nga analiza e vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtari dhe atyre të përzgjedhura me short, konstatohet se natyra juridike e çështjes del qartë, edhe në rastet kur ajo nuk është identifikuar në mënyrë të shprehur, duke u bazuar në identifikimin e elementeve dhe kriterëve ligjore të trajtuara në secilin vendim gjyqësor burim vlerësimi.

**- Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm**

Referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtari identifikon dhe citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në mos citimin apo listimin e dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk referojnë në zgjidhjen e çështjes objekt shqyrtimi.

Duke qenë se burim vlerësimi janë vetëm vendimet që i përkasin kategorisë së çështjeve penale, konstatohet se gjyqtari identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në pjesën e posaçme të Kodit Penal, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit, si dhe dispozitat e pjesës së

---

<sup>1</sup> Vendimet nr. 362 (896), datë 18.02.2020, nr.1766 (3809), datë 14.07.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe nr.52-2022-75 (11), datë 26.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

përgjithshme të Kodit Penal, në funksion të analizës së instituteve dhe parimeve të zbatueshme.

Konkretisht, në funksion të cilësimit juridik të faktit penal, gjyqtari identifikon:

- nenin 137/1 të K. Penal lidhur me veprën penale *“Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”*,<sup>2</sup>
- nenin 291 të K. Penal lidhur me veprën penale *“Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”*. Për vlerësimin dhe analizën e elementëve të anës objektive, gjyqtari referon nenin 184 të ligjit nr. 8387, datë 22.07.1998 *“Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”* në lidhje me drejtimin e mjetit nën ndikimin e alkoolit, si dhe nenet 53 dhe 115 të këtij ligji lidhur me kategoritë e lejedrejtitimit për drejtimin e automjeteve;<sup>3</sup>
- nenin 199/a të K. Penal lidhur me veprën penale *“Ndërtim i paligjshëm”*, duke identifikuar dispozita të ligjit nr.107/2014 *“Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”* me qëllim dhënien e kuptimit të nocioneve *“ndërtim”*, *“ndërtim/punim pa leje”*, *“ndërtim në shkelje të lejes”* dhe *“Punime ndërtimore”*;<sup>4</sup>
- nenin 290/2 të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”*, në lidhje me dispozitat e Kodit Rrugor, duke qenë se kjo është një dispozitë *“blankete”*;<sup>5</sup>
- nenin 130/a të Kodit Penal lidhur me veprën penale *“Dhuna në familje”* dhe, për interpretimin e këtij koncepti, referon nenin 3 të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 *“Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”*;<sup>6</sup>
- nenet 141/a dhe 186 të K.Penal lidhur me veprat penale *“Trafikim i mjeteve motorike”* dhe *“Falsifikimi i dokumenteve”*;<sup>7</sup>
- nenet 79/b, 279/1 dhe 237/3 të K. Penal lidhur me veprat penale *“Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit”*, *“Prodhim dhe mbajtje pa leje e armës së ftohtë”* dhe *“Goditja për shkak të detyrës”*,<sup>8</sup>
- nenin 145 të K. Penal lidhur me veprën penale *“Mashtrim në sigurime”*;<sup>9</sup>
- nenin 242 të K. Penal lidhur me veprën penale *“Mosbindjes ndaj urdhrit të punonjësit të policisë s rendit publik”*.<sup>10</sup>

Referohen dispozita pjesës së përgjithshme të Kodit Penal: nenin 14 në lidhje analizën e elementëve të anës subjektive të veprës penale; nenet 12 dhe 17 lidhur me moshën për përgjegjësi penale dhe rrethanat e përjashtimit nga përgjegjësia; nenet 25 dhe 26, lidhur me institutin e bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale si dhe nenin 19 të Kodit Penal në lidhje me institutin e mbrojtjes së nevojshme;<sup>11</sup> nenet 30/3 e 37 në funksion të aplikimit të

---

<sup>2</sup> Vendimet nr.585 (1662), datë 11.06.2020 dhe nr.64 (118), datë 09.01.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

<sup>3</sup> Vendimet nr.1521 (4202), datë 22.10.2020, nr.678 (2331), datë 06.06.2022, nr.131 (383), datë 27.01.2020, nr.403 (1033), datë 26.02.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

<sup>4</sup> Vendimi nr.1311 (4490), datë 31.10.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

<sup>5</sup> Vendimi nr.1766 (3809), datë 14.07.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

<sup>6</sup> Vendimet nr.361 (895), datë 18.02.2020 dhe nr. 362 (896), datë 18.02.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

<sup>7</sup> Vendimi nr.805 (2787), datë 06.07.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Neni 186/1 të K. Penal identifikohet edhe në vendimin nr.2301 (5898), datë 22.12.2021.

<sup>8</sup> Vendimi nr.52-2022-75 (11), datë 26.04.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

<sup>9</sup> Vendimi nr.292 (736), datë 10.02.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

<sup>10</sup> Vendimi nr. 1136 (3221), datë 16.09.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

<sup>11</sup> Vendimi nr. 362 (896), datë 18.02.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

dënimeve plotësuese, konkretisht atij të ndalimit për të drejtuar automjete;<sup>12</sup> nenet 1/c dhe 47 lidhur me parimet në caktimin e llojit dhe masës së dënimit; nenet 48 dhe 49 lidhur me rrethanat lehtësuese dhe rënduese; nenet 59 dhe 63 lidhur me alternativat e dënimit, si vënia në provë apo detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik; nenin 62 lidhur me pasojat në rast të shkeljes së kushteve dhe detyrimeve gjatë kohës së provës; nenin 66 lidhur me institutin e parashkrimit të ndjekjes penale;<sup>13</sup> neni 64 dhe dispozitat e ligjit nr.79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, lidhur institutin e lirimit para kohe me kusht.<sup>14</sup>

Krahas dispozitave të Kodit Penal dhe ligjeve të posaçme si më sipër, gjyqtari ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe dispozitat e Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës si: neni 53 të Kushtetutës për mbrojtjen e veçantë nga shteti të familjes;<sup>15</sup> nenin 29 të Kushtetutës lidhur me mosdënimin pa ligj; nenin 6 të KEDNJ dhe 42 të Kushtetutës lidhur me të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

**- Sa i përket ligjit procedural:**

Referuar natyrës së çështjes (*kërkesa të fazës së ekzekutimit, seancës paraprake apo gjykim themeli*), apo ritit të gjykimit (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar*), gjyqtari identifikon dispozitat procedurale, si më poshtë:

- nenin 69 të K.Pr.Penale lidhur me juridiksionin penal në gjykimin e çështjes; nenet 13/2 shkronja “ç”, 15, 16, 17, 18 të K.Pr.Penale lidhur me përbërjen e turpi gjykues dhe shkaqet e papajtueshmërisë apo përjashtimit nga gjykimi;<sup>16</sup>
- nenet 327/4, 327 dhe 331 të K.Pr.Penale, në funksion të analizës së mosrespektimi i afatit 10-ditor që i njihet të pandehurit për të paraqitur memorie, dokumente, apo të kërkoj nga organi i akuzës kryerjen e hetimeve shtesë, sjell pavlefshmërinë e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq;<sup>17</sup>
- nenin 388, shkronja “d” të K.Pr.Penale në rastin e deklarimit të pafajshëm të të pandehurit, për shkak se nuk provohet që vepra penale që i atribuohet, të jetë kryer prej tij;<sup>18</sup>
- nenet 261, 262, 389 të K.Pr.Penale lidhur me disponimin e gjykatës për shuarjen e masës së sigurimit kur vendoset pezullimi me kusht i vendimit;<sup>19</sup>
- nenet 36, 190, 217 dhe 218 të K.Pr.Penale lidhur me konfiskimin si dhe disponimin për sendet e sekuestruara;<sup>20</sup>

---

<sup>12</sup> Vendimi nr. 1766 (3809), datë 14.07.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

<sup>13</sup> Vendimet nr.639 (685), datë 02.02.2021, nr.805 (2787), datë 06.07.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

<sup>14</sup> Vendim nr.172 (1330), datë 12.04.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

<sup>15</sup> Vendimet nr.361 (895), datë 18.02.2020 dhe nr.362 (896), datë 18.02.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

<sup>16</sup> Vendimet nr.403 (1033), datë 26.02.2020, nr.131 (383), datë 27.01.2020, nr.845 (3102), datë 25.07.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

<sup>17</sup> Vendimi nr.14 (35), datë 11.01.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

<sup>18</sup> Vendimet nr. 361 (895), datë 18.02.2020, nr.2301 (5898), datë 22.12.2021 dhe nr.362 (896), datë 18.02.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

<sup>19</sup> Vendimi nr.1766 (3809), datë 14.07.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

<sup>20</sup> Vendimi nr.146 (661), datë 22.02.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

- nenet 13/2 shkronja “dh”, 69/1, 74 dhe 477 të K.Pr.Penale, në lidhje me nenin 38 të ligjit nr. 79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, lidhur me juridiksionin gjyqësor penal, kompetencën lëndore e tokësore ku vuan dënimin kërkuesi;<sup>21</sup>
- nenin 391 të K.Pr.Penale lidhur me deklarinin për falsitetin e dokumenteve; nenin 190 të K.Pr.Penale lidhur me disponimin për provat materiale;<sup>22</sup>
- nenet 393 e 485 të K.Pr.Penale lidhur me shpenzimet gjyqësore;
- nenin 332/dh të K.Pr.Penale lidhur me ftesën drejtuar palëve për të paraqitur bisedimet përfundimtare në rastin se i pandehuri kërkon gjykim të shkurtuar;<sup>23</sup>
- nenet 405/6, 403 dhe 352 të K.Pr.Penale në funksion të analizës së përmbushjes së kriterit formal për pranimin në shqyrtim të kërkesës për gjykim të shkurtuar në gjykimin në themel, në rastet kur i pandehuri nuk ka pasur mundësi ta paraqesë atë përpara gjyqtarit të seancës paraprake dhe kërkesa është paraqitur përpara deklarinimit të hapur të shqyrtimit gjyqësor;<sup>24</sup>
- nenin 406/dh të K. Pr. Penale në lidhje me aspektet procedurale të shqyrtimit të çështjes nga gjykata, kushtet dhe kriteret ligjore për miratimin e marrëveshjes së fajësisë të përcaktuara në nenet 406/d, 406/dh, 406/e, 406/ë dhe 406/f të K.Pr.Penale;<sup>25</sup>
- nenet 151 dhe 152 të K.Pr.Penale lidhur me përcaktimin se asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar nga ligji;
- nenin 69 të K.Pr.Penale, në lidhje me nenin 75 të ligjit nr. 81, datë 25.06.1920 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, lidhur me juridiksionin penal, si dhe kompetencën tokësore e lëndore të gjykatës sipas ligjit të posaçëm;<sup>26</sup>
- neni 328/1, pika 1 “germa “d” të K.Pr.Penale lidhur me rastin e pushimit të çështjes me arsyetimin se ndjekja penale nuk duhet të vazhdojë më për shkak të plotësimit të afatit të parashkrimit;<sup>27</sup>
- nenin 331/3 të K.Pr.Penale lidhur me elementët formalë që përmban kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq; nenin 327/3 të K.Pr.Penale lidhur me njoftimin e përfundimit të hetimeve; nenin 332/ë të K.Pr.Penale lidhur me përmbajtjen e fashikullit të gjykimit;<sup>28</sup>
- nenin 375 të K.Pr.Penale lidhur me ndryshimin e cilësimit juridik të figurës së veprës penale të konsumuar nga i pandehuri.<sup>29</sup>

*Sa i përket aspektit të evidentimit të konfliktit të normave, nga tërësia e vendimeve gjyqësore burim vlerësimi nuk konstatohet ndonjë rast ku analiza e konfliktit të normave të ketë qenë e domosdoshme, në mbështetje të arsyetimit lidhur me zgjidhjen e çështjes.*

## **KONKLuzioni**

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, gjyqtari shfaq aftësi shumë të mira në drejtim të paraqitjes dhe analizës së fakteve, si të atyre me natyrë procedurale, në të cilat jepet një panoramë e qartë e ecurisë së çështjes dhe veprimeve të

<sup>21</sup> Vendimi nr.172 (1330), datë 12.04.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

<sup>22</sup> Vendimi nr.2301 (5898), datë 22.12.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

<sup>23</sup> Vendimi nr.2134 (5389), datë 17.11.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

<sup>24</sup> Vendimi nr.1136 (3221), datë 16.09.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

<sup>25</sup> Vendimi nr.585 (1662), datë 11.06.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

<sup>26</sup> Vendimet nr.936 (4291), datë 27.10.2020 dhe nr.285 (1919), datë 30.03.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

<sup>27</sup> Vendimi nr. 805 (2887), datë 06.07.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

<sup>28</sup> Vendimet nr.131 (383), datë 27.01.2020, nr.1237 (4273), datë 18.10.2022, nr.184 (478), datë 29.01.2020 dhe nr.845 (3102), datë 25.07.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

<sup>29</sup> Vendimi nr.52-2022-75 (11), datë 26.04.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

kryera, së bashku me analizën ligjore, në rastet kur elementët proceduralë lidhen me trajtimin e kërkesave të palëve, ashtu edhe të fakteve thelbësorë të çështjes. Këto të fundit paraqiten në mënyrë koncize, të plotë dhe analitike, duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Gjyqtari gjithashtu demonstroi aftësi shumë të larta në identifikimin e normës apo normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, në citimin dhe analizimin e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së saj, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në lidhje me treguesin “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

#### ***1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes***

Interpretimi i ligjit është ekskluziviteti i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet t'i japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtari lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore referohen ose citohen duke u shoqëruar në çdo rast me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes, si në ato me natyrë procedurale ashtu edhe në ato që kanë lidhje me themelin e çështjes. Tipar karakteristik i gjyqtarit është se citimi ose referimi i dispozitave, kryesisht atyre që aplikohen drejtpërdrejt për zgjidhjen në themel të çështjes, është shoqëruar me interpretimit të tyre në mënyrë të individuale, para aplikimit mbi faktin konkret. Gjyqtari kryesisht përdor interpretimin *teleologjik* të normës konkrete duke identifikuar qëllimin e saj, por edhe interpretimin *literal* dhe *sistematik* të normave, duke përqasur kuptimin e normës me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara.

#### ***- Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:***

Në vendimet burim vlerësimi evidentohet se gjyqtari interpreton dispozitat materiale (*nenet 79/b, 237/3, 279/1, 145, 130/a/1, 290/2, 137/1, 199/a, 242, 141/a dhe 186 të Kodit Penal*) në funksion të cilësimit juridik të veprës penale për të cilën kërkohet dërgimi në gjyq apo gjykimi i të pandehurit dhe të përcaktimit të përgjegjësisë së autorit në kryerjen e saj, duke bërë zbërthimin e normave të pjesës së posaçme të Kodit Penal dhe duke analizuar elementët e figurës së veprës penale për të cilën procedohet, dhe sipas rastit elementët cilësues të saj. Gjyqtari interpreton në nivel teorik normën relevante të K.Penal, duke bërë një përshkrim të përgjithshëm në lidhje me elementët dallues të veprës penale, e në vijim,

duke e përqsaur me faktet e provuara në gjykim, nxjerr konkluzionin në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal dhe përgjegjësinë penale të autorit.<sup>30</sup>

Dispozitat e Kodit Penal (*të pjesës së posaçme*) analizohen duke zbërthyer të katër elementët e figurës së veprës penale, por duke u përqendruar më tepër në anën objektive dhe subjektive të saj, duke u ndalur në elementë të tillë siç është forma e kryerës së veprës penale të parashikuar nga neni 145 i K. Penal dhe duke analizuar se ky krim kryhet nëpërmjet *gënjeshtrës ose/dhe b) shpërdorimit të besimit*. Ky element e dallon nga veprat e tjera penale kundër pasurisë. Duhet të arrihet të provohet se veprimet e të pandehurit përfshijnë elementë të natyrës së mëposhtme: deklarata e rreme e një fakti material; dijeninë nga ana e të pandehurit se deklarata është e pavërtetë, qëllimi i të pandehurit për të mashtruar viktimën e supozuar; bazueshmëria e justifikuar e viktimës së supozuar në deklaratën e të pandehurit, dhe dëmi i shkaktuar viktimës së supozuar prej mashtrimit. Të gjithë këta elementë përgjithësisht duhet të ekzistojnë së bashku në momentin e lidhjes së marrëveshjes me personin e dëmtuar.<sup>31</sup>

Përpos interpretimit të dispozitave materiale penale të pjesës së posaçme në lidhje me kualifikimin ligjor të veprave penale përkatëse për të cilat akuzohen të pandehurit, në çdo rast gjyqtari interpreton *dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal*, në drejtim të elementëve dhe instituteve, si më poshtë:

- interpreton dispozitat që lidhen me përcaktimin e dënimit penal, duke u ndalur në individualizimin e dënimit (*neni 47 i K. Penal*), duke mbajtur parasysh llojin dhe kufijtë e dënimit; rrezikshmërinë e veprës penale; rrezikshmërinë e autorit; shkallën e fajit; rrethanat lehtësuese e rënduese.
- interpreton nenin 19 të K. Penal lidhur me mbrojtjen e nevojshme, duke analizuar konceptet e sulmit dhe mbrojtjes.<sup>32</sup>
- interpreton dispozitat materiale penale (*nenet 59 dhe 63 të Kodit Penal*), në lidhje me aplikimin e alternativave të ekzekutimit të dënimit me burgim, konkretisht pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë, si dhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim të shoqëruar me detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik, duke u ndalur në kriteret ligjore që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative nga i pandehuri për të përfituar nga këto alternativa të dënimit me burgim.
- interpreton nenin 64 të K. Penal lidhur në lidhje me institutin e lirimit me kusht dhe qëllimin e tij: nga njëra anë, ai synon të shpërblejë të dënuarin që ka dhënë prova të rehabilitimit (qëllimi i posaçëm); nga ana tjetër, shërben si shembull për të dënuarit e tjerë (qëllimi i përgjithshëm). Gjithashtu, interpreton këtë nen në lidhje me kushtet kumulative që duhet të plotësohen për zbatimin e lirimit me kusht ndaj kërkuesit, etj.

***Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale***, gjyqtari i jep rëndësi interpretimit të normës së zbatueshme si në rastet kur trajtohen çështje të procedurës, ashtu edhe në rastet kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel. Konkretisht gjyqtari:

---

<sup>30</sup> Në të gjitha vendimet penale të themelit konstatohet analiza teorike e dispozitave penale në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal, para aplikimit mbi faktet e çështjes

<sup>31</sup> Vendimi nr.292 (736), datë 10.02.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

<sup>32</sup> Vendimi nr.362 (896), datë 18.02.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

- Interpreton kushtet ligjore të parashikuara në nenin 375 të K.Pr.Penale, lidhur me ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, të ngritur si akuzë nga ana e prokurorisë. Interpreton literalisht nenin 152 të K.Pr.Penale sipas të cilit asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar nga ligji.<sup>33</sup>
- Interpreton elementët për vlefshmërinë e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq.
- Trajton aspektin procedural të zhvillimit të seancës paraprake referuar parashikimeve të K. Pr. Penale, duke evidentuar elementët që duhet të merren në shqyrtim nga gjykata në gjykime të kësaj natyre dhe përkatësisht: nëse konstatohet ndonjë pavlefshmëri absolute e akteve procedurale apo papërdorshmëri e provave; nëse ka prova të mjaftueshme në mbështetje të akuzës; ekzistenca e përgjegjësisë penale dhe cilësimi juridik i faktit; kërkesa për gjykim të shkurtuar; si dhe përmbajtja e fashikullit të gjykimit.
- Interpreton në mënyrë sistematike nenet 327 dhe 331 të K.Pr.Penale, duke vlerësuar se nga organi i akuzës nuk është respektuar afati 10-ditor për paraqitjen e memorieve, dokumenteve apo për kërkimin e kryerjes së hetimeve shtesë. Në këtë mënyrë janë shkëlur përcaktimet e nenit 327/4 dhe, si pasojë, kërkesa për dërgimin në gjyq rezulton e pavlefshme; për këtë shkak është deklaruar pavlefshmëria e saj dhe është vendosur kthimi i akteve prokurorit të çështjes.<sup>34</sup>

***Në lidhje me aftësinë për të përdorur jurisprudencën relevante***, rezulton se gjyqtari ka identifikuar dhe përdorur gjerësisht vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ-së, në mbështetje të argumenteve të tij në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, kryesisht në rastet si më poshtë:

- Referon vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.2, datë 25.05.2015, ku janë përcaktuar kushtet, kriteret dhe situatat që duhet të mbahen në konsideratë nga gjykata në aplikimin e lirit me kusht.<sup>35</sup>
- Vendimin Unifikues nr. 7, datë 14.10.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë lidhur me detyrimin e organit të akuzës të provojë tej çdo dyshimi të arsyeshëm çdo element që përbën veprën penale për të cilën akuzohet i pandehuri. Vendimin e GJEDNJ *Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë*, lidhur me standardin e vlerësimit të provave. Vendimet nr. 57, datë 21.12.2012 dhe nr. 47, datë 07.11.2011 të Gjykatës Kushtetuese lidhur me parimin e prezumimit të pafajësisë. Vendimin nr. 196, datë 12.06.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë lidhur me respektimin e parimit të kontradiktoritetit midis palëve. Vendimin nr. 201, datë 05.07.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë lidhur me parimin se askush nuk mund të dënohet me një provë të vetme e cila nuk lidhet me prova të tjera. Vendimin nr. 97, datë 20.03.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë lidhur me vlerën e bisedave telefonike, pa asnjë provë tjetër, direkte ose indirekte.<sup>36</sup>

<sup>33</sup> Vendimi nr. 52-2022-75 (11), datë 26.04.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë. Neni 152 i K.Pr.Penale interpretohet edhe tek vendimet nr.2301 (5898), datë 22.12.2021 dhe nr.361 (895), datë 18.02.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

<sup>34</sup> Vendimi nr.14 (35), datë 11.01.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

<sup>35</sup> Vendim nr.172 (1330), datë 12.04.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

<sup>36</sup> Vendimet nr.361 (895), datë 18.02.2020, nr.362 (896), datë 18.02.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe nr.52-2022-75 (11), datë 26.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

- Referon vendimin unifikues nr. 2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë lidhur me karakteristikat e gjykimit të shkurtuar si një përfitim që nuk duhet të shkojë në dëm të dhënies së drejtësisë.
- Referon vendimin nr. 354, datë 20.12.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në lidhje me natyrën e veprës penale të “Mashtimit në sigurime” dhe cilësimin juridik të faktit penal sipas kësaj figure, si dhe për sqarimin e nocionit “gënjeshtër” si formë e kryerjes së kësaj vepre penale. Gjithashtu, trajton kuptimin e krimit vazhdues dhe karakteristikat që duhet të paraqesë një vepër penale, në drejtim të elementëve të anës objektive dhe subjektive, për t’u cilësuar si e tillë, duke iu referuar qëndrimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 284, datë 06.10.2000, si dhe vendimit nr. 12, datë 16.01.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.<sup>37</sup>
- Referon vendimin unifikues nr. 4, datë 15.04.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, lidhur me interpretimin e kushteve të bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale.<sup>38</sup>
- Vendime të Gjykatës së Lartë lidhur me alternativën e dënimit me burgim, pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë (qëllimi, kushtet, kriteret), konkretisht vendimin nr. 99, datë 09.04.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Udhëzimin nr. 5, datë 15.05.1979 të Plenumit të Gjykatës së Lartë “Mbi dënimin me kusht”, lidhur me qëndrimin e mbajtur se një nga kriteret që duhet të udhëhiqet gjykata në vënien në provë është konkretizimi i saktë i rrezikshmërisë shoqërore që paraqet subjekti i veprës penale. Rekomandimin e Këshillit të Evropës, Rekomandimi Nr. R (99) 22 i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare në lidhje me mbipopullimin e burgjeve, paragrafi 1.<sup>39</sup>
- Vendimin nr.77, datë 03.02.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë lidhur me pakujdesinë në formën e vetëbesimit të tepruar.<sup>40</sup>
- Vendimin unifikues nr. 7, datë 14.10.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, lidhur me faktin se gjykata në caktimin e llojit dhe masës së dënimit duhet të hetojë në drejtim të personalitetit të të pandehurit dhe ndër të tjera të mbajë në konsideratë edhe sjelljen e autorit si para ashtu edhe pas kryerjes së veprës penale.<sup>41</sup>
- Referon vendimin nr. 47, datë 26.07.2012 të Gjykatës Kushtetuese, lidhur me qëllimin e dënimit me gjobë, në frymën e Kushtetutës.<sup>42</sup>

***Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës***, nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi, rezulton kujdesi i gjyqtarit që gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes të referohen dhe zbatohen parimet e përgjithshme të së drejtës, gjë që realizohet duke i përmendur ato shprehimisht apo të nxjerra nga konteksti i arsytimit të vendimit. Gjyqtari njeh, referon dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit, siç janë:

<sup>37</sup> Vendimi nr.292 (736), datë 10.02.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

<sup>38</sup> Vendimi nr.805 (2787), datë 06.07.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

<sup>39</sup> Vendimet nr.1311 (4490), datë 31.10.2022, nr.678 (2331), datë 06.06.2022, nr.1766 (3809), datë 14.07.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

<sup>40</sup> Vendimi nr.1766 (3809), datë 14.07.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

<sup>41</sup> Vendimet nr.64 (118), datë 09.01.2020 dhe nr. nr.292 (736), datë 10.02.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

<sup>42</sup> Vendimi nr.1136 (3221), datë 16.09.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër

- Parimet e përgjithshme në caktimin e dënimit, si të barazisë para ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, të humanizmit, përshtatshmërisë së llojit dhe masës së dënimit (neni 47, 1/b dhe 1/c i K. Penal), të cilat referohen dhe analizohen më pas në raport me rrethanat konkrete të çështjes.
- Parimin e barrës së provës përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se vepra penale është kryer nga i pandehuri.
- Parimin e procesit të rregullt ligjor (neni 6 i KEDNJ dhe neni 42 i Kushtetutës) si dhe garantimin e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, duke iu referuar aspektit procedural të gjykimit që lidhet me të drejtën e mbrojtjes; Parimi i prezumimit të pafajësisë i sanksionuar në nenin 4 të K.Pr.Penale.

## KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural apo kur ato shërbejnë për zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Dispozitat e ligjit material rezultojnë të jenë referuar dhe interpretuar në mënyrë konsistente, duke i zbërthyer paraprakisht në elementë përbërës të tyre, duke identifikuar qëllimin dhe funksionin e dispozitës para aplikimit të saj mbi faktet e çështjes konkrete. Evidentohet një kujdesi i gjyqtarit për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ, si dhe për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

### 1.B. Arsyetimi ligjor

#### 1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtari gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore është e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës dhe parimeve të përgjithshme të së drejtës procedurale dhe materiale, evidentohet përdorimi i termave dhe shprehjeve në gjuhën latine, të cilat shoqërohen në çdo rast me dhënien e kuptimit përkatës në gjuhën shqipe, pa krijuar paqartësi lidhur me përmbajtjen apo kuptimin e tyre. Gjithashtu, këto terma/shprehje zakonisht paraqiten të dalluara në kllapa ose thonjëza (si p.sh. “*nullum crimen, nulla poena sine culpa*”, “*condicio sine qua non*”, “*in dubio pro reo*”, “*extrema ratio*”). Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve apo shprehjeve që cenojnë

integritetin e personit, si dhe konstatohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyës apo denigrues.

Në arsyetimin e vendimeve vërehet respektimi i rregullave gramatikore dhe i sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke mundësuar një paraqitje të qartë të rrethanave procedurale, të fakteve të çështjes dhe të analizës juridike. Në të gjitha vendimet gjyqësore rezulton përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (*ë dhe ç*). Fjalitë janë të ndërtuara saktë dhe paraqiten në një rrjedhë logjike, njësoj si edhe paragrafët apo nënndarjet e arsyetimit. Nuk rezulton përdorimi i termave apo fjalëve që mund të krijojnë paqartësi në lidhje me kuptimin e tyre apo kontekstin në të cilin përdoren.

Gjyqtari përdor fjali me gjatësi mesatare, të ndërthurura dhe të qarta, duke shprehur mendimin juridik në mënyrë të kuptueshme jo vetëm për profesionistët e së drejtës, por edhe për publikun e gjerë. Fjalitë dhe paragrafët janë të lidhura në mënyrë logjike me njëra-tjetrën. Vendimet janë të strukturuar në nënndarje të identifikuar me tituj dhe paragrafë, duke orientuar qartë për përmbajtjen e tyre dhe duke ndjekur një rend kronologjik. Po ashtu, organizimi në paragrafë mundëson kalimin e qartë të mendimit nga një pjesë në tjetrën.

#### KONKLZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari i kushton një rëndësi të veçantë arsyetimit të vendimeve, në aspektin e qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta vëmendje vihet re edhe në lidhje me koncizitetin e pjesës përshkruese, në secilën nënndarje të saj, duke i dhënë në arsyetim peshën e duhur çdo elementi të vendimit, në përputhje me përmbajtjen e tij.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

#### ***1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit***

Organizimi i arsyetimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kyçe të vendimit mund të humbasin, apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsyetimi të ndjekë një format të qartë organizimi, në funksion të orientimit të lexuesit dhe të kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsyetimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike, që juristët/gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër, dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*), CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*) etj., të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në

zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/ pyetjen për zgjidhje, normën relevante që duhet të zbatohet për zgjidhjen e saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzionin e arritur.

- ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:***

Gjyqtari ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar nga pikëpamja formale, së cilës i përmbahet në prezantimit të fakteve, në identifikimin e ligjit të zbatueshëm, në argumentimin ligjor, si dhe në lidhjen e tyre me konkluzionet e arritura. Gjyqtari ndjek përgjithësisht një metodologji të njëjtë në strukturimin e pjesëve përbërëse të vendimit, duke organizuar pjesën përshkruese-arsyetuese në nënndarje të identifikuar me tituj, në funksion të orientimit mbi qëllimin e secilës pjesë. Gjithashtu konstatohet se gjyqtari në rastin konkret ka një metodologji të qartë sipas pjesëve përbërëse të vendimit. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

*Në pjesën hyrëse* gjejnë pasqyrim: të dhënat e regjistrimit dhe gjykata që ka gjykuar çështjen, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data e shqyrtimit, palët dhe përfaqësuesit e tyre (*prokuroria, i pandehuri, mbrojtësi i caktuar kryesisht ose i zgjedhur, viktimja sipas rastit*), prania ose mungesa e tyre në seancë, objekti i shqyrtimit (*akuza ose objekti i kërkesës*), si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, të paraqitura në mënyrë të përmbledhur.

*Pjesa përshkruese-arsyetuese* është e ndarë në disa pjesë, të cilat kryesisht janë të listuar formalisht me tituj që përgjithësisht ndjekin këtë renditje:

- (i) *Procedura*, duke u ndalur kryesisht në ecurinë procedurale të çështjes, si dhe në aspektet që lidhen me të drejtat e palëve, njoftimin dhe pjesëmarrjen e tyre në gjykim. Gjithashtu, në disa raste evidentohet analiza dhe vlerësimi kryesisht nga gjykata lidhur me çështje të juridiksionit dhe kompetencës, si dhe vendimmarrjet e ndërmjetme të gjykatës gjatë procesit, si në rastin e shqyrtimit të kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar në çështjet penale të themelit.
- (ii) *Rrethanat e çështjes*, ku përmbahen: faktet e çështjes së bashku me përshkrimin dhe analizën e provave të lejuara dhe administruara në gjykim, të analizuara në raport me njëra tjetrën, duke konkluduar për faktin e provuar si deduksion i analizës së provave. Gjyqtari i kushton rendësi kësaj pjese të arsyetimit të vendimit, duke u paraqitur faktet e çështjes në mënyrë analitike, por edhe koncize, duke i dhënë qartësi faktit penal.
- (iii) *Vlerësimi i gjykatës* ku gjyqtari merr në analizë ligjin e zbatueshëm, duke bërë interpretimin abstrakt të tij, para aplikimit mbi faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje dhe konkluzion mbi çështjen. *Në vendimet penale të themelit*, vlerësimi i gjykatës përfshin analizën e ligjit material të zbatueshëm në raport me faktet e çështjes, konkretisht: në lidhje me përgjegjësinë penale të të pandehurit; lidhur me caktimin e llojit dhe të masës së dënimit; si dhe lidhur me shpenzimet gjyqësore. *Në vendimet e seancës paraprake* me objekt "Dërgimin e çështjes në gjyq", merret në analizë ligji i zbatueshëm procedural penal dhe aplikimi i tij në faktet konkrete të çështjes lidhur me ekzistencën e provave të mjaftueshme për të dërguar në gjyq akuzën.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës, data e shpalljes së vendimit dhe nënshkrimi i gjyqtarit dhe sekretares gjyqësore. Konstatohet se dispozitivi i vendimeve është i plotë dhe në to gjejnë pasqyrim: disponimi i gjykatës mbi : (i) përgjegjësinë penale të të pandehurit mbi akuzën që i atribuohet (*deklarimin fajtor apo të pafajshëm*), apo mënyrën e disponimit në çështjet specifike të seancës paraprake (*dërgimin në gjyq apo pushimin e procedimit penal*), (ii) dënimin dhe masën e dënimit, (iii) llogaritjen e dënimit, (v) mënyrën e ekzekutimit të tij, (iv) disponimi mbi provat materiale dhe (v) shpenzimet gjyqësore.

Vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural penal, referuar natyrës së tyre dhe kategorisë së çështjes, dhe konkretisht elementët e përcaktuar në: (i) nenet 332/ç, 332/dh dhe 332/e dhe nenin 329/b të K.Pr.Penale, në vendimet e seancës paraprake për dërgimin e çështjes në gjyq apo pushimin e procedimit penal, dhe (ii) nenin 383 të K.Pr.Penale, në vendimet penale të themelit.

#### KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, e cila është e dukshme në aspektin vizual dhe të përmbajtjes, duke i dhënë qëndrueshmëri dhe kuptueshmëri vendimit. Ndjekja e një strukture të njëjtë, të mirë përcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tij.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit”, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

#### **1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik**

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin e vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GJEDNJ është shprehur se, megjithëse gjykatave i lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përsa i përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për tu ankuarve.<sup>43</sup>

- ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:***

<sup>43</sup> Vendimi I GJEDNJ, Çështja Dadjanastassion vs Greqisë, datë 16.12.1992, faqe 33.

Në të gjitha vendimet burim vlerësimi rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, i detajuar dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të nevojshëm në raport me faktin penal, si dhe çdo aspekt që kërkon analizë në lidhje me çështjet procedurale të gjykimit. Arsyetimi i vendimeve burim vlerësimi ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material penal, duke bërë një analizë tërësore dhe koncize të provave të administruara, në funksion të përcaktimit të qartë të fakteve të vlerësuara si të provuara në gjykim.

Në vendimet burim vlerësimi karakteristikë e gjyqtarit është paraqitja dhe analiza e detajuar e fakteve që kanë rezultuar të provuara në gjykim, si dhe vlerësimi i tyre në drejtim të ekzistencës së elementeve të figurës së veprës penale për të cilën procedohet, rolit dhe përgjegjësisë penale të të pandehurit në raport me faktin penal. Çdo fakt i vlerësuar si i provuar lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë provën/provat përkatëse, me aspektet ligjore konkrete të cilat ato mbështesin, si dhe elementin që sjell secila prej tyre në shërbim të provueshmërisë së tij. Gjyqtari integron në mënyrë të natyrshme faktin e provuar me analizën dhe interpretimin e ligjit të zbatueshëm në rastin konkret, si në drejtim të kualifikimit ligjor të faktit penal, ashtu edhe në drejtim të vlerësimit të kushteve ligjore për zgjidhjen e çështjeve me karakter procedural.

Gjyqtari ndalet në evidentimin e qartë dhe në mënyrë të natyrshme të lidhjes shkak-pasoje mes veprimeve të të pandehurit në raport me faktin penal të provuar në çështjet e themelit, faktin penal objekt akuze në çështje të seancës paraprake, apo në raport me faktin për të cilin kërkohet pushimi i procedimit penal. Në çdo rast interpretimi dhe analiza e integruar e normave ligjore procedurale dhe materiale, në raport me faktet e provuara në gjykim, i shërben arsyetimit ligjor dhe zhvillimit të argumentimin logjik, në mbështetje të konkluzioneve të tij për zgjidhjen e çështjes, kryesisht në drejtim të:

- (i) analizës së figurës konkrete të veprës penale për të cilën procedohet, zbërthimin dhe analizën e elementëve e saj, si dhe autorësisë e të pandehurit;
- (ii) institutit procedural të gjykimit të shkurtuar, duke analizuar në çdo rast kushtet procedural për pranimin e tij së bashku me analizën dhe vlerësimin mbi kushtet thelbësore që vlerësohen për procedimin me këtë rit të posaçëm gjykimi;
- (iii) analizës lidhur me kushtet dhe kriteret ligjore të përcaktimi dhe individualizimit të dënimit, analizës lidhur me rrethanat rënduese dhe lehtësuese që ndikojnë për përcaktimin e dënimit si dhe aplikimin në këtë drejtim të parimeve mbi të cilat caktohet dënimi penal në funksion të arritjes së qëllimit të tij. Po ashtu gjyqtari zhvillon analizën e kushteve ligjore të aplikimit të alternativave të dënimit me burgim duke u ndalur në analizën e kriterëve ligjore që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative për aplikimin e kësaj alternative.

***Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve***, në të gjitha vendimet burim vlerësimi ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u pozicionuar në atë pjesë të arsyetimit me të cilën lidhet pretendimi. Duke u analizuar në përmbajtje të arsyetimit ligjor në pjesët përkatëse që i referohen pretendimeve konkrete, ato kanë marrë gjithmonë një përgjigje të argumentuar, të mbështetur në ligj dhe në prova, duke u përfshirë në mënyrë të natyrshme si pjesë e arsyetimit tërësor.

## KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, konstatohet se gjyqtari shfaq aftësi shumë të lartë në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim ligjor-konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të zhvillimit të mendimit juridik në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsytimit. Në çdo vendim të analizuar, mendimi logjik ka vijueshmëri, mbështetet në interpretimin e ligjit të zbatueshëm dhe pasurohet me qëndrimet e praktikës gjyqësore, si dhe integrimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës që gjejnë zbatim. Arsytimi i vendimeve është i qartë dhe i plotë, duke marrë në analizë dhe duke iu përgjigjur të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve, me qëllim dhënien e një përgjigje të argumentuar mbi mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.*

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

## 2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit Sokol Shehu në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm, ashtu edhe në panel me të tjerë.*

### 2.A. Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë

#### 2.A.a Respektimi i afateve ligjore

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtari ka gjykuar gjithsej 327 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, të cilat i përkasin kategorisë së çështjeve “Çështje Penale Krime – Gjykimi me marrëveshje”, “Çështje Penale Kundërvajtje – Gjykimi me marrëveshje apo Miratim urdhër penale”, “Kërkesa penale të fazës së hetimit paraprak” dhe “Penale të seancës paraprake”.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, si dhe të dhënave statistikore gjyqtari rezulton se nga 327 çështje për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, 105 prej tyre janë shqyrtuar në tejkalim të këtij afati ndërsa 222 çështje janë shqyrtuar brenda afateve ligjore.

**Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (105 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (327 çështje), gjyqtari rezulton që të ketë gjykuar 32.11% të çështjeve jashtë afatit ligjor.**

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari shpjegon se gjatë periudhës 2020–2022 ka përballuar një ngarkesë shumë të lartë pune për shkak të volumit të madh të çështjeve penale dhe mungesës së gjyqtarëve si pasojë e procesit të vettingut, duke gjykuar gjithsej 1773 çështje, mesatarisht 591 në vit, një numër që tejkalon standardet minimale. Ai thekson se, pavarësisht kësaj ngarkese, ka ndërmarrë të gjitha masat për respektimin e afateve ligjore dhe se tejkalimet kanë qenë minimale, kryesisht në disa ditë dhe rrallë në muaj, të shkaktuara nga faktorë objektivë si pandemia COVID-19, pezullimi i veprimtarisë gjyqësore, mosnjohimi i rregullt i palëve, mungesa ose ndryshimi i prokurorëve dhe mbrojtësve, kërkesat e palëve, kompleksiteti i çështjeve me shumë të pandehur, si dhe ndryshimet ligjore procedurale. Gjithashtu, gjyqtari sqaron se seancat janë planifikuar në përputhje me ligjin dhe se çdo shtyrje ka synuar garantimin e një procesi të rregullt ligjor, respektimin e parimit të kontradiktoritetit dhe të drejtave të palëve. Në përfundim, ai vlerëson se tejkalimet nuk kanë ardhur si pasojë e neglizhencës apo paaftësisë së tij organizative, por nga pamundësi objektive, duke kërkuar që të gjitha çështjet të konsiderohen si të gjykuara brenda afateve ligjore.<sup>44</sup>

Analiza e të dhënave statistikore nga ana e vlerësuesit duhet bërë në mënyrë të tillë që të shmangen përfundimet që vijnë për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Për analizën e këtij treguesi, vlerësuesi nuk bazohet vetëm në të dhënat statistikore, por merr në konsideratë të gjitha të dhënat nga burimet e tjera të vlerësimit. Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore, për 105 çështjet e shqyrtuara jashtë afateve ligjore, rezulton se:

- Për çështjet me objekt *“Miratim marrëveshje për pranim fajësie dhe caktim dënimi”*, neni 406/dh i K.Pr.Penale parashikon një afat shqyrtimi prej 30 ditësh. Nga të dhënat statistikore rezulton se çështjet me numër rendor 80, 81 (*Tabela nr.8, viti 2020*), 87 dhe 88 (*Tabela nr.8, viti 2021*), si dhe 116 (*Tabela nr.8, viti 2022*) janë shqyrtuar përkatësisht në 69, 62, 60, 55 dhe 62 ditë nga data e regjistrimit. Megjithatë, konstatohet se këto çështje janë regjistruar dhe i janë caktuar gjyqtarit me short në muajin korrik dhe kanë përfunduar në muajin shtator. Nëse nga kohëzgjatja e gjykimit do të përjashtohej periudha e lejes vjetore (35 ditë), këto çështje do të rezultonin të përfunduara brenda afatit ligjor. Në këtë kategori rezulton se çështja me numër rendor 13 (*Tabela nr.8, viti 2021*) është gjykuar për 32 ditë, duke tejkaluar afatin ligjor vetëm me 2 ditë, një tejkalim i cili vlerësohet si i papërfillshëm, duke pasur parasysh edhe ditët e pushimit javor që ndikojnë në përlllogaritjen e afatit. ***Për këtë arsye, 6 (gjashtë) çështje do të përlllogariten si çështje të gjykuara brenda afati ligjor.***
- Për çështjet me objekt *“Miratim urdhri penal”*, neni 406/b i Kodit të Procedurës Penale parashikon që shqyrtimi të kryhet brenda 10 ditëve nga depozitimi i kërkesës. Rezulton se çështja me numër rendor 12 (*Tabela nr. 9, viti 2022*) është shqyrtuar për 13 ditë, duke kaluar afatin ligjor vetëm me 3 ditë, një tejkalim i cili vlerësohet si i papërfillshëm, duke pasur parasysh edhe ditët e pushimit javor që ndikojnë në

<sup>44</sup> Gjyqtari ka referuar shpjegimet si më sipër, paraqitur në mënyrë të përmbledhur në këtë raport, por që parashtrihen në mënyrë të detajuar në Raportin Analitik

përlllogaritjen e afatit. ***Për këto arsye, kjo çështje do të përlllogaritet si çështje e gjykuar brenda afatit ligjor.***

- Për çështjet me objekt “*Revokim/Zëvendësim mase sigurimi*”, neni 260 i K.Pr.Penale parashikon afatin 5 ditor të gjykimit. Referuar të dhënave statistikore rezulton se çështjet me numër rendor 2 dhe 11 (*Tabela 10, viti 2020*) janë shqyrtuar për 6 ditë, duke tejkaluar afatin ligjor me vetëm 1 ditë. Tejkallim i cili vlerësohet të jetë i papërfillshëm, duke konsideruar edhe ditët e pushimit javor, të cilat ndikojnë në përlllogaritjen e afatit. ***Për këto arsye, këto 2 (dy) çështje do të përlllogariten si çështje që janë gjykuar brenda afatit ligjor.***
- Për çështjet me objekt “*Dërgimin e çështjes në gjyq*”, paragrafi i tretë i nenit 332 të Kodit të Procedurës Penale parashikon një afat 30-ditor për shqyrtimin e tyre. Referuar të dhënave statistikore, rezulton se çështjet me numër rendor 57, 58 (*Tabela nr. 11, viti 2020*) janë regjistruar dhe shortuar në gjykatë në muajin mars të vitit 2020 dhe ka përfunduar në muajin maj të po atij viti. Gjatë kësaj periudhe, veprimtaria gjyqësore ka qenë e pezulluar për një afat prej 1 muaji e 17 ditësh (nga data 10.03.2020 deri më 27.04.2020), për shkak të pandemisë së COVID-19. Duke përjashtuar periudhën e pezullimit të veprimtarisë gjyqësore, këto çështje do të kishin përfunduar brenda afatit ligjore. Gjithashtu, evidentohet se çështjet me numër rendor 139, 140, 141, 142 (*Tabela nr. 11, viti 2020*), 159, 160, 162 (*Tabela nr. 11, viti 2021*) dhe 117 (*Tabela nr. 11, viti 2022*), janë regjistruar dhe shortuar në gjykatë në muajin korrik dhe kanë përfunduar në muajin shtator. Duke përjashtuar periudhën e lejes vjetore (35 ditë), këto çështje do të kishin përfunduar brenda afatit ligjor. Po kështu, në këtë kategori çështjesh evidentohet se çështjet me numër rendor 8, 10, 23, 30, 31, 35, 39, 67, 82, 105, 123, 162, 163, 168, 169, 177 (*Tabela nr. 11, viti 2020*) nr. 18 (*Tabela nr. 11, viti 2021*) janë shqyrtuar përkatësisht për 41, 42, 46, 37, 34, 33, 33, 34, 35, 35, 35, 35, 35, 36, 36, 33 dhe 35 ditë, duke tejkaluar afatin ligjor me 3 deri në 12 ditë. Tejkallime këto që vlerësohen të jenë të papërfillshme, duke konsideruar këtu se në pesë çështje në kohëzgjatjen e gjykimit ka ndikuar edhe procedura e mbartjeve të dosjeve nga administrata gjyqësore. ***Për këtë arsye, këto 26 (nëntëmbëdhjetë) çështje do të përlllogariten si çështje të përfunduara brenda afatit ligjor.***

Sa më sipër, në total nga 327 çështje të cilat kanë të parashikuar afat ligjor për përfundimin e tyre, rezulton që gjyqtari ka përfunduar jashtë afatit ligjor 70 çështje (duke zbritur 35 çështjet e sipërcituara) ose **rreth 21% të çështjeve** që parashikojnë afat ligjor për përfundimin e tyre, përqindje e cila sipas Metodologjisë pikëzohet me 9 pikë.

Në Metodologji, lidhur më këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjitha burimeve të vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si: kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit të punës, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së tij, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Në rastin konkret, pavarësisht numrit të çështjeve për të cilat ligji parashikon afate ligjore gjykimi, rezulton se gjyqtari ka pasur një ngarkesë të lartë çështjesh në periudhën e vlerësimit, në total ka gjykuar 1773 çështje, nga të cilat 1195 çështje me palë kundërshtare dhe 578 pa palë kundërshtare.

## KONKLZIONI

Analiza e të dhënave statistikore nuk kryhet nga vlerësuesi në mënyrë thjesht matematikore, por përbën një vlerësim logjik të të dhënave burimore. Në përcaktimin e pikëzimit për rastin konkret, janë marrë në konsideratë këta faktorë:

- i) ngarkesa e lartë e gjyqtarit;
- ii) mendimi i zëvendëskryetarit, si dhe vetëvlerësimi i gjyqtarit lidhur me shkaqet objektive që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve;
- iii) numri i çështjeve me afat ligjor, konkretisht 327 të tilla, që përbëjnë rreth 18% të totalit të çështjeve të shqyrtuara gjatë periudhës së vlerësimit;
- iv) tejkalimi i pragut të përqindjes që sjell një pikëzim më të lartë vetëm me 1%.

Në këto kushte, gjyqtari pikëzohet për këtë tregues dy nivele më lartë se ai që rezulton nga të dhënat statistikore, konkretisht 15 pikë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi përqindja e çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjor është 21%, por ndërkohë gjyqtari ka përfunduar një numër të lartë çështjesh ku 18% ose 327 janë çështje me afat ligjor.*

### **2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, si dhe tabelave të të dhënave statistikore, rezulton se gjyqtari ka gjykuar gjithsej **1446 çështje** për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, të cilat i përkasin kategorive të çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, “Penale-krime”, “Penale-kundërvajtje”, “Seanca paraprahe-kërkesa për pushimin e procedimit penal” dhe “Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë”, për të cilat vendimi nr. 261/2, datë 14.04.2010, i KLD përcaktonte këto standarde minimale kohore për gjykimin në gjykatën e shkallës së parë, si vijon:

- jo më tej se 6 muaj (180 ditë) për gjykimet civile të themelit;
- jo më tej se 9 muaj (270 ditë) për krimet me maksimumin e dënimit deri në 10 vjet dhe 12 muaj (365 ditë) për krimet me minimumin e dënimit jo më pak se 10 vjet;
- jo më tej se 4 muaj (120 ditë) për kundërvajtjet penale;
- jo më tej se 2 muaj (60 ditë) për gjykimin e kërkesave civile pa palë kundërshtare;
- jo më tej se 2 muaj (60 ditë) për gjykimin e kërkesave administrativo-penale.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, si dhe tabelave të të dhënave statistikore, rezulton se nga 1446 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 231 çështje (137 çështje në vitin 2020, 42 çështje në vitin 2021 dhe 52 çështje në vitin 2022), prej tyre ose **15.97% janë gjykuar tej standardit minimal kohor në fuqi**.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit, gjyqtari dhe zëvendëskryetari e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, duke parashtruar se tejkalimi i afateve orientuese në disa çështje gjyqësore ka ardhur për shkaqe objektive dhe të përligjura, të njohura edhe nga

praktika e GJEDNJ-së lidhur me standardin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, dhe në asnjë rast për shkak të neglizhencës apo sjelljes së gjyqtarit.

Në këtë kuadër, gjyqtari ka evidentuar se ndër faktorët kryesorë kanë qenë ngarkesa shumë e lartë në punë, veçanërisht në seksionin penal gjatë viteve 2020–2022, si dhe delegimet në gjykata të tjera, si edhe pezullimi i gjykimeve sipas dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Penale. Gjithashtu, gjyqtari ka theksuar se një ndikim të rëndësishëm kanë pasur vështirësitë në njoftimin e palëve, veçanërisht të pandehurve dhe viktimave, për shkak të adresave të pasakta apo mungesës së tyre, duke sjellë përsëritje të procedurave të njoftimit dhe shtyrje të seancave gjyqësore. Po ashtu, ai ka evidentuar si faktorë edhe sjelljen procedurale të palëve, kërkesat për shtyrje, mungesat e prokurorëve për shkak të ngarkesës apo prioritizimit të çështjeve me masa sigurimi, si dhe nevojën për administrimin e provave dhe dëshmitarëve në gjykimet e zakonshme.

Më tej, gjyqtari ka përmendur problematika të tjera si mungesa ose zëvendësimi i mbrojtësve, kërkesat për kohë për përgatitjen e mbrojtjes, kompleksiteti i procedurave në seancat paraprake, përfshirja e një numri më të madh subjektsh në proces pas ndryshimeve ligjore, si dhe vështirësi organizative, përfshirë mungesat e prokurorëve dhe vonesat në paraqitjen e akteve nga institucionet përkatëse. Ai ka theksuar gjithashtu vonesat që lidhen me fazën e ekzekutimit të vendimeve, për shkak të mungesës së burimeve njerëzore dhe paraqitjes së vonuar të dokumentacionit, si dhe rastet kur janë kërkuar ekspertime, të cilat janë shtyrë për shkak të mungesës ose ngarkesës së ekspertëve.

Në përfundim, gjyqtari ka vlerësuar se, pavarësisht këtyre faktorëve, ai ka përmbushur në një nivel të lartë standardet minimale për gjykimin e çështjeve, duke garantuar zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe pa e kthyer respektimin e afateve në një qëllim në vetvete në dëm të cilësisë së drejtësisë.<sup>45</sup>

Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore për 231 çështjet që rezultojnë të jenë shqyrtuar jashtë standardit minimal kohor, konstatohet se në disa raste vonesat në përfundimin e tyre janë ndikuar nga faktorë objektivë, si periudha e lejes vjetore të gjyqtarit (35 ditë), procedura e mbartjes së dosjeve nga administrata gjyqësore në fundvit (15 ditë), pezullimi i veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore për 47 ditë për shkak të pandemisë COVID-19,<sup>46</sup> si dhe koha e pezullimit të gjykimit. Nëse këto periudha nuk do të përfshiheshin në përlogaritjen e afatit të gjykimit, një pjesë e këtyre çështjeve do të rezultonin të përfunduara brenda standardit minimal kohor. Konkretisht:

***Për kategorinë “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, Tabela nr.1*** rezulton se:

---

<sup>45</sup> Gjyqtari ka referuar shpjegimet si më sipër, paraqitur në mënyrë të përmbledhur në këtë raport, por që parashtrohen në mënyrë të detajuar në Raportin Analitik

<sup>46</sup> Me Vendimin nr. 127, datë 10.03.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat e Republikës së Shqipërisë për shkak të situatës së krijuar nga përhapja e COVID-19. Ky pezullim u vijua me Vendimin nr. 128, datë 24.03.2020, për periudhën 25.03.2020–07.04.2020, si dhe me Vendimin nr. 133, datë 06.04.2020, për periudhën 08.04.2020–22.04.2020. Me Vendimin nr. 143, datë 22.04.2020, u vendos rifillimi i veprimtarisë gjyqësore duke filluar nga data 27.04.2020. Për rrjedhojë, veprimtaria gjyqësore ka qenë e pezulluar për periudhën 10.03.2020–27.04.2020, në total 47 ditë.

- çështja me numër rendor 1 (*viti 2020*), i është caktuar gjyqtarit me short në datën 27.06.2019 dhe ka përfunduar në datën 03.02.2020, me një kohëzgjatje prej 221 ditësh. Nëse nga kjo kohëzgjatje do të përjashtohej periudha e lejes vjetore (35 ditë), çështja do të kishte përfunduar për 186 ditë. Duke pasur në vëmendje se në kohëzgjatjen e gjykimit ka ndikuar gjithashtu edhe procedura e mbartjes së dosjeve nga administrata gjyqësore në fund të vitit, kjo çështje vlerësohet se ka përfunduar brenda standardit minimal kohor. ***Për rrjedhojë, kjo çështje do të përlllogaritet si çështje e përfunduar brenda këtij standardi.***

***Për kategorinë “Penale krime”, Tabela nr.8*** rezulton se:

- Çështjet me numër rendor 19, 24, 102, 103, 104, 107, 114, 122 dhe 127 (*viti 2020*), 3 dhe 14 (*viti 2021*), 12 (*viti 2022*) janë gjykuar përkatësisht për 643, 502, 548, 514, 574, 629, 600, 352, 406, 461, 339, 487 ditë. Referuar shënimeve të pasqyruara në tabelën e të dhënave statistikore, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin elektronik të gjykatës për secilën çështje, evidentohet se në të gjitha këto raste gjykata, me vendim të ndërmjetëm dhe në referim të nenit 352/1 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur pezullimin e gjykimit për një periudhë njëvjeçare, për shkak se i pandehuri në gjendje të lirë, megjithëse janë kryer të gjitha kërkimet sipas neneve 140 – 142, nuk është paraqitur në seancë dhe nuk ka pasur dijeni personalisht për zhvillimin e gjykimit. Nëse nga kohëzgjatja e gjykimit do të zbriteshin periudha gjatë së cilës çështjet kanë qenë të pezulluara, rezulton se ato do të kishin përfunduar brenda afatit standard prej 9 muajsh (270 ditë), të përcaktuar për gjykimin e çështjeve penale që lidhen me krime me maksimumin e dënimit deri në 10 vjet. Ndërkohë, për çështjet me numër rendor 74, 96 dhe 110, të përfunduara përkatësisht për 676, 707 dhe 649 ditë, përveç periudhës së pezullimit të gjykimit prej 365 ditësh, ka ndikuar edhe pezullimi i veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore për shkak të pandemisë COVID-19 për një periudhë prej 47 ditësh. Duke zbritur edhe këtë periudhë nga kohëzgjatja totale e gjykimit, rezulton se edhe këto çështje do të kishin përfunduar gjithashtu brenda afatit standard kohor.
- Çështjet me numër rendor 56 dhe 95 (*viti 2020*) janë gjykuar për një kohëzgjatje përkatësisht 297 dhe 275 ditë. Megjithatë, duke përjashtuar periudhën 47-ditore të pezullimit të veprimtarisë gjyqësore për shkak të pandemisë COVID-19, kohëzgjatja e gjykimit do të rezultonte përkatësisht 250 dhe 228 ditë, duke i bërë këto çështje përfunduar brenda standardit minimal kohor.
- Çështjet me numër rendor 25 (*viti 2020*) dhe çështjet me numër rendor 52 dhe 108 (*viti 2022*), kanë përfunduar gjykimin përkatësisht për 308, 294 dhe 278 ditë. Duke zbritur periudhën e lejes vjetore prej 35 ditësh, këto çështje do të kishin përfunduar përkatësisht për 273, 259 dhe 243 ditë, pra brenda afatit standard kohor, dhe në rastin e parë duke e tejkaluar atë vetëm me 3 ditë. ***Për këto arsye, këto 20 (njëzet) çështje do të përlllogariten si çështje që kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor.***

***Për kategorinë “Penale kundërvajtje”, Tabela nr.9*** rezulton se:

- Çështjet me numër rendor 1, 5, 15, 16, 18, 19, 20, 24, 29 (*viti 2020*), 19 (*viti 2021*), si dhe 5, 20, 21, 26, 27 dhe 31 (*viti 2022*) janë gjykuar përkatësisht për 490, 524, 543, 529, 544, 505, 526, 559, 469, 377, 412, 397, 432, 492, 442 dhe 378 ditë. Referuar shënimeve të pasqyruara në tabelën e të dhënave statistikore, si dhe

verifikimeve të kryera në sistemin elektronik të gjykatës për secilën çështje, evidentohet se në të gjitha këto raste gjykata, me vendim të ndërmjetëm dhe në referim të nenit 352/1 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur pezullimin e gjykimit për një periudhë njëvjeçare. Ndërkohë, në po këto çështje, përveç periudhës së pezullimit të gjykimit prej 365 ditësh, ka ndikuar edhe pezullimi i veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore për shkak të pandemisë COVID-19 për një periudhë prej 47 ditësh, si dhe periudha e lejes vjetore e gjyqtarit. Duke zbritur edhe këto periudha nga kohëzgjatja totale e gjykimit, rezulton se të gjitha këto çështje do të kishin përfunduar brenda afatit standard minimal kohor prej 4 muajsh (120 ditë), të përcaktuar për gjykimin e çështjeve penale për kundërvajtje. ***Për këto arsye, këto 16 (gjashtëmbëdhjetë) çështje do të përlllogariten si çështje që kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor***

***Për kategorinë “Penale, seancë paraprake”, Tabela nr.11*** rezulton se:

- Çështja me numër rendor 153 (viti 2020), me objekt “Kërkesë për pushimin e procedimit penal”, është përfunduar në një afat prej 63 ditësh, duke tejkaluar afatin standard me vetëm 3 ditë, një tejkallim i cili vlerësohet i papërfillshëm, pasi në kohëzgjatjen e gjykimit kanë ndikuar edhe ditët e pushimit javor.
- Në të njëjtën kategori, çështjet me numër rendor 59, 60, 61, 62, 63 dhe 64 (viti 2020), të caktuara gjyqtarit me short gjatë muajit shkurt dhe të përfunduara në qershor, janë shqyrtuar përkatësisht për 103, 106, 106, 106, 99 dhe 106 ditë. Megjithatë, duke përjashtuar periudhën 47-ditore të pezullimit të veprimtarisë gjyqësore për shkak të pandemisë COVID-19, kohëzgjatja e gjykimit për këto çështje do të rezultonte brenda standardit minimal prej 2 muajsh (60 ditë).
- Në po këtë kategori, çështjet me numër rendor 83, 84, 85, 87, 94 dhe 95 (viti 2020) janë shqyrtuar përkatësisht për 76, 76, 76, 74, 89 dhe 89 ditë. Afati standard është tejkaluar me 6 deri në 29 ditë, por pjesërisht këtë tejkallim e ka shkaktuar periudha e pezullimit të veprimtarisë gjyqësore gjatë pandemisë, pasi çështjet i janë caktuar gjyqtarit me short më 2, 14 dhe 16 prill 2020, ndërkohë që veprimtaria gjyqësore ka qenë e pezulluar deri më 27.04.2020.
- Po ashtu, çështjet me numër rendor 130, 131, 132, 133, 136, 137, 138, 158, 160 (viti 2020), 163, 166, 177 (viti 2021) dhe 121, 126 (viti 2022), të caktuara gjyqtarit me short gjatë muajit qershor ose korrik dhe të përfunduara në shtator ose tetor, me objekt “Kërkesë për pushimin e procedimit penal”, janë përfunduar përkatësisht në 69, 77, 77, 73, 65, 68, 68, 82, 72, 92, 79, 94, 68 dhe 75 ditë. Duke zbritur periudhën e lejes vjetore (35 ditë), këto çështje do të kishin përfunduar brenda standardit minimal kohor prej 2 muajsh (60 ditë). ***Për këto arsye, këto 27 (njëzet e shtatë) çështje do të përlllogariten si çështje që kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor.***

***Për kategorinë “Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë”, Tabela nr.12*** rezulton se:

- Çështjet me numër rendor 133, 134 dhe 152 (viti 2020), të caktuara gjyqtarit me short në fund të muajit shkurt ose fillim të muajit mars të vitit 2020 dhe të përfunduara në maj ose qershor të po atij viti, janë shqyrtuar përkatësisht për 79, 98 dhe 93 ditë. Megjithatë, duke përjashtuar periudhën 47-ditore të pezullimit të

veprimtarisë gjyqësore për shkak të pandemisë COVID-19, kohëzgjatja e gjykimit për këto çështje do të kishte rezultuar brenda standardit minimal prej 2 muajsh (60 ditë)

- Në të njëjtën kategori, çështjet me numër rendor 107, 114, 115, 116, 120, 122, 128, 188 (viti 2020), 52 (viti 2021), si dhe 113, 115, 130 (viti 2022), kanë përfunduar përkatësisht në një afat prej 63, 64, 62, 69, 69, 69, 69, 62, 62, 65, 62 dhe 62 ditë. Afati standard minimal kohor është tejkaluar me 2 deri në 9 ditë, tejkalime të cilat vlerësohen si të papërfillshme, pasi në disa prej këtyre çështjeve kohëzgjatjen e gjykimit e ka ndikuar periudha e pezullimit gjatë COVID-19.
- Po në këtë kategori, çështjet me numër rendor 56, 57, 58, 59, 60, 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 71, 74, 77 (viti 2020), 59, 60, 62, 66, 68, 69, 70, 76, 94, 99 (viti 2021), si dhe 52, 54, 61, 68 (viti 2022), të caktuara gjyqtarit me short gjatë muajit qershor ose korrik dhe të përfunduara në shtator ose tetor, janë shqyrtuar përkatësisht për 63, 80, 66, 84, 70, 62, 63, 62, 75, 63, 62, 71, 73, 77, 78, 79, 75, 93, 69, 62, 62, 92, 79, 78, 71, 74, 76, 82 dhe 93 ditë. Duke zbritur periudhën e lejes vjetore (35 ditë), këto çështje do të kishin përfunduar brenda standardit minimal kohor. ***Për këto arsye, këto 32 (tridhjetë e dy) çështje do të përlllogariten si çështje që kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor.***

Nëse në përlllogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor, do të përjashtoheshin 96 çështjet e analizuara më sipër, të cilat, nëse do të zbritet periudha e lejes vjetore, periudha e mbartjeve të dosjeve, pezullimi i gjykimit apo koha e pezullimit të veprimtarisë gjyqësore për shkak të COVID-19, rezultojnë të përfunduara brenda afatit. Bazuar në analizën e mësipërme rezulton se nga 1446 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 135 prej tyre ose rreth **9.3% janë gjykuar jashtë standardit** minimal kohor në fuqi, i cili sipas Metodologjisë pikëzohet me 5 pikë.

## **KONKLuzioni**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se standardi minimal kohor në fuqi është respektuar në 90.7% të çështjeve, duke u tejkaluar ky standard vetëm në 9.3 % të çështjeve.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:*** Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është shumë e lartë dhe vlerësohet në nivelin “0-10%”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

### **2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje**

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është si më poshtë:

- i. Në kategorinë e çështjeve “*Civile të përgjithshme me palë kundërshtare*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 214.3 ditë, pra **më e gjatë** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj;
- ii. Në kategorinë e çështjeve “*Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 4.6 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj;
- iii. Në kategorinë e çështjeve “*Penale-krime*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 93.1 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 9 apo 12 muaj;
- iv. Në kategorinë e çështjeve “*Penale-kundërvajtje*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 173.4 ditë, pra **më e gjatë** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 4 muaj;
- v. Në kategorinë e çështjeve “*Seancë paraprake- kërkesë për pushimin e procedimit penal*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 32.5 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj;
- vi. Në kategorinë e çështjeve “*Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 42.2 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari dhe zëvendëskryetari e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin “*Shumë të lartë*”, duke parashtruar se është përpjekur maksimalisht të respektojë afatet e parashikuara si standarde minimale kohore sipas kategorive, por gjithmonë duke u kujdesur që kjo të mos cenojnë të drejtat e palëve në proces, kontradiktoritetin, mbrojtjen efektive, garantimin e hetimit të plotë dhe të gjithanshëm për zgjidhjen e drejtë të çështjes, cilësinë e gjykimit dhe të drejtën për proces të rregullt ligjor.

#### **KONKLuzioni**

Në tërësi, duke u referuar të dhënave nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, si dhe krahasimit të kohës mesatare të dedikuar çdo çështjeje për të gjitha kategoritë me standardin minimal kohor në fuqi për secilën kategori, rezulton se koha mesatare për 4 nga 6 kategoritë e çështjeve është më e shkurtër se standardi. Koha mesatare rezulton më e gjatë se standardi vetëm për kategoritë “*Civile të përgjithshme me palë kundërshtare*” dhe “*Penale – kundërvajtje*”, duke tejkaluar afatin përkatës për 34 dhe 53 ditë. Ky tejkalim konsiderohet i papërfillshëm duke marrë parasysh ngarkesën e gjyqtarit dhe natyrën jo detyruese të standardeve orientuese. Për kategorinë e çështjeve penale – kundërvajtje, kohëzgjatja është ndikuar nga çështjet e pezulluara për një periudhë njëvjeçare, sipas parashikimeve të nenit 352/1 të Kodit të Procedurës Penale. Bazuar në këtë analizë logjike të të dhënave statistikore, gjyqtari pikëzohet për këtë tregues në një nivel më të lartë se ai që rezulton nga përlllogaritja matematikore, duke u vlerësuar me 5 pikë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:*** Referuar sa më sipër, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje konsiderohet më e shkurtër ose e barabartë me standardin minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve, duke e pikëzuar me 5 pikë.

## **2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, për të gjithë periudhën e vlerësimit, si raport midis numrit të çështjeve të përfunduara (1773 çështje), me numrin e çështjeve të caktuara (1784 çështje), brenda periudhës 3-vjeçare të vlerësimit, **është 99.38%** përqindje e cila sipas Metodologjisë pikëzohet me 10 pikë.

### **KONKLUZIONI**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, meqenëse rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 99.38%.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” është “+99%”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

## **2.A.d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar të gjyqtarit Sokol Shehu për periudhën e vlerësimit, është si më poshtë vijon:

- Për çështje të kategorisë “*Civile të përgjithshme me palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar është 6.6 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K.Pr.Civile.
- Për çështje të kategorisë “*Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar është 1.8 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K.Pr.Civile.
- Për çështje të kategorisë “*Penale-krime*”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar është 15.1 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K.Pr.Penale.
- Për çështje të kategorisë “*Penale-kundërvajtje*”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar është 18.8 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K.Pr.Penale.
- Për çështje të kategorisë “*Kërkesa penale të hetimit paraprak*” koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar është:
  - Për kërkesa me objekt “*Vleftësim arresti/ndalimi dhe caktim mase sigurimi*”, 1.5 ditë, **pra më e shkurtër** se afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 249 të K.Pr.Penale.
  - Për kërkesa me objekt “*Caktim mase sigurimi*”, koha mesatare e arsyetimit është 0 ditë, **pra e barabartë** me afatin procedural i parashikuar nga neni 244/1 i K.Pr.Penale, i cili kërkon që vendimi të jepet i arsyetuar.
  - Për kërkesa me objekt “*Verifikim i kushteve të zbatimit të masës së sigurimit*”, 2 ditë, **pra e barabartë** me afatin procedural 48 orë i parashikuar nga neni 248 i K.Pr.Penale.
  - Për kërkesa me objekt “*Zëvendësim/revokim mase sigurimi*”, 2.5 ditë, **pra më**

e shkurtër se afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 249 i K.Pr.Penale.

- Për kërkesa me objekt “*Shuarje mase sigurimi*”, 3.5 ditë, pra e gjatë se afati procedural 48 orë i parashikuar nga neni 261/3 dhe 248/2 i K.Pr.Penale.

ër çështje të kategorisë “*Seancë paraprake*” koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar është:

- ër çështje me objekt “*Dërgimin e çështjes në gjyq*”, 8.9 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 10 ditë i parashikuar nga neni 332/dh i K.Pr.Penale.

- ër çështje për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, 14.7 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K.Pr.Penale.

ër çështje të kategorisë “*Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*” koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është:

- ër kërkesa me objekt për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, 14.1 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K.Pr.Penale.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari dhe zëvendëskryetari e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, duke argumentuar se pavarësisht ngarkesës tepër të madhe dhe volumit të çështjeve të gjykuara për vitet 2020-2022 ai ka respektuar aftin procedural të arsyetimit dhe dorëzimit të vendimeve për secilën kategori të parashikuar në Kodin e Procedurës Penale.

## KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar klasifikohet si “*Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve*”, pasi vetëm për një nënkategori çështjesh rezulton që afati procedural të jetë tejkaluar me vetëm 1.5 ditë, çka e bën atë të papërfillshëm për tu marrë në konsideratë. Për të gjitha kategoritë e tjera të çështjeve, koha e arsyetimit rezulton dukshëm më e shkurtër se afati procedural. Ky tejkallim i kufizuar, së bashku me kohëzgjatjen minimale të tij, sipas Metodologjisë së vlerësimit justifikojnë zbatimin e një niveli më të lartë pikëzimi, me pasojë pikëzimin me 15 pikë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë.*

## **2.B. Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore**

### ***2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh,<sup>47</sup> duke përjashtuar ato pa palë kundërshtare, rezulton si më poshtë:

- (i) për kategorinë “*Penale themeli*” është 2.4 seanca;
- (ii) për kategorinë “*Penale seancë paraprake*” është 2.1 seanca.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore, për të gjitha çështjet me palë kundërshtare të përzgjedhura me short për vlerësim, rezulton të jetë **2 seanca gjyqësore**.

Nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short evidentohet se gjyqtari ka kryer në mënyrë efektive të gjitha veprimet për vënien në lëvizje të çështjeve. Ai ka mbikëqyrur në mënyrë të rregullt dhe pa vonesa dërgimin e njoftimeve, të cilat paraqiten të plota dhe të qarta për palët që u drejtohen. Në asnjë rast nuk konstatohet mungesë e njoftimeve ndaj palëve dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin në kohë të seancave gjyqësore. Konstatohet nga aktet në dosjet burim vlerësimi se gjyqtari për çdo çështje ka disponuar me urdhër ose vendim për caktimin e datës së shqyrtimit të çështjes, duke caktuar seancën e parë gjyqësore dhe duke pasqyruar në këtë akt urdhërimit e sekretarisë gjyqësore për kryerjen e njoftimeve të palëve ndërgjyqëse, sipas K.Pr.Penale, duke urdhëruar kryerjen e njoftimeve për palët dhe marrjen e masave për të siguruar prezencën apo shoqërimin e të pandehurve.

Seancat përgjithësisht janë shtyrë për shkaqe të ndryshme procedurale të tilla si: *për mos konfirmimit të njoftimit për të pandehurin; për mosparaqitjen e prokurorit të çështjes; për njoftimin e mbrojtësit të caktuar kryesisht; për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim, etj.*

Pra, në tërësi, shtyrjet e seancave gjyqësore kanë qenë për shkaqe objektive, të pavarura nga veprimet e gjyqtarit së çështjes, si dhe për të kryer veprimet e nevojshme procedurale me qëllim zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtave procedurale të palëve dhe pjesëmarrësve në gjykim.

## **KONKLUZIONI**

Bazuar sa më sipër, për treguesin “*Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 2 seanca dhe në çdo rast gjyqtari ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproductive,

---

<sup>47</sup> Referuar tabelave me të dhëna statistikore të dërguara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, rezulton se nuk është gjeneruar numri i seancave gjyqësore. Për pasojë, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, numri mesatar i seancave gjyqësore do të përlllogaritet duke iu referuar çështjeve me palë kundërshtare, të përzgjedhura me short për vlerësim

për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave, shkalla e aftësisë vlerësohet në nivel maksimal, duke e pikëzuar me 15 pikë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive”, aftësia e gjyqtarit është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

### **2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor**

Referuar Raportit Analitik dhe dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, rezulton se në çdo rast gjyqtari ka vënë në lëvizje çështjet, duke marrë vendim për caktimin e seancës gjyqësore menjëherë pas caktimit të tyre me short, në përputhje me rregullat dhe procedurat e parashikuara sipas kategorive përkatëse të çështjeve. Konkretisht, evidentohet se gjyqtari ka vënë në lëvizje dosjet brenda afatit 5-ditor, në përputhje me nenin 332/1 të K.Pr.Penale për çështjet e seancës paraprake me objekt dërgimin në gjyq, nenin 329/b për çështjet me objekt pushimin e procedimit penal, si dhe nenet 333/1 dhe 406/dh të K.Pr.Penale për çështjet penale të themelit.

Në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtari i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore, duke caktuar seancën, si dhe ka treguar kujdes për marrjen e masave për njoftimin e palëve, me qëllim zhvillimin e seancave gjyqësore efektiv.

Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt dhe në përputhje me kërkesat procedurale të parashikuara për gjykimin në shkallë të parë, si për çështjet penale (nenet 341 e vijues të K.Pr.Penale), ashtu edhe sipas rrit të ndjekur, përfshirë gjykimin e shkurtuar (nenet 405 e vijues) dhe procedurat e seancave paraprake (neni 332/c i K.Pr.Penale).

Gjatë gjykimit gjyqtari tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, të mbrojtësve, relativitetin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqet e mosparaqitjes së palëve ose të pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të të pandehurit, shpalljen e trupit gjykues, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar, dhënien e fjalës palëve për parashtrimin dhe paraqitjen e fakteve dhe të provave, shtyrjen e seancave gjyqësore, duke pasqyruar shkakun në çdo rast, si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (njoftimin e palëve, etj.). Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre dhe kur është rasti, edhe me arsyet e vendimmarrjes.

Nga dosjet e vëzhguara rezulton se, në përgjithësi, seancat janë çelur në kohë, megjithëse konstatohet një numër i vogël vonesash deri në 15 minuta, të konsideruara të

papërfillshme. Vetëm në disa raste të kufizuara (7 seanca, rreth 16%) janë evidentuar vonesa nga 15 deri në 60 minuta, të shkaktuara kryesisht nga zgjatja e seancave pararendëse ose vonesa në shoqërimin e të pandehurve apo kërkuesve nga toga e shoqërimit. Seancat gjyqësore janë dokumentuar rregullisht në procesverbal, janë regjistruar në audio dhe janë pasqyruar me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

#### **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 20 pikë.*

### **2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore**

#### **2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes**

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se aktet e dosjes janë të renditura në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht, të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Pavarësisht se nuk ka një rregullim që të përcaktojë në mënyrë të shprehur mënyrën e renditjes së akteve në dosjen gjyqësore, renditja duhet të jetë e tillë që të lehtësojë aksesimin e saj. Në rastin konkret, renditja sipas llojit të akteve procedurale, e ndërthurur edhe me veprimet procedurale të kryera nga gjyqtari gjatë gjykimit, është dhe konsiderohet si një mënyrë që e bën të lehtë dhe të shfrytëzueshme dosjen. Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (*njoftimet, shkresat, procesverbalet e seancave*). Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.

#### **KONKLUZIONI**

Në tërësi, rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin kronologjik, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit, për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.*

## 2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short janë të administruara të gjitha aktet dhe dokumentacioni i krijuar gjatë procesit gjyqësor. Në çdo dosje përfshihen si aktet shkresore të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, ashtu edhe aktet e hartuara nga gjykata.

### KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë aftësie në lidhje me këtë tregues. Në dosjet e vëzhguara nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit, apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

## 3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

*Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.*

### 3.A. Etika në punë

#### 3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për gjyqtarin Sokol Shehu, gjatë periudhës së vlerësimit nuk janë dhënë ose zbatuar masa disiplinore.

Sa i përket ankesave, për periudhën e vlerësimit vitet 2020-2022, ndaj gjyqtarit rezulton të jenë paraqitur 9 (nëntë) ankesa,<sup>48</sup> për të cilat, pas verifikimit, Inspektor i Lartë i Drejtësisë

<sup>48</sup> Sipas informacionit të dërguar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me shkresën nr. 436/1 prot., datë 27.02.2025, rezulton se për gjyqtarin subjekt vlerësimi janë paraqitur 10 ankesa, ndërkohë që nga vendimet bashkëlidhur shkresës rezulton se vendimi nr. 255/7 prot., datë 13.12.2022 mbi arkivimin e ankesës së

me vendimet nr.2031/2 prot., datë 04.05.2021, nr. 4295/1 prot, datë 14.01.2022, nr.337/2 prot., datë 31.03.2022, nr.2041/1 prot., datë 16.09.2022, nr.640/3 prot., datë 04.10.2022, nr. 1281 prot., datë 19.04.2023, nr.211/1 prot., datë 20.04.2023, nr.22/1 prot., datë 15.05.2023 dhe nr.1251/1 prot., datë 15.05.2023 ka vendosur arkivimin e tyre pas shqyrtimit fillestar.

Lidhur me shkaqet e ankesave dhe rezultateve të verifikimit të tyre, referuar materialeve të dërguara nga ILD, rezulton si më poshtë:

I- Ankesat e shtetasit F.L., regjistruar pranë Zyrës së ILD me nr. 2982 prot., datë 10.12.2020 dhe nr. 2031 prot., datë 13.04.2021, në përmbajtje të cilave ankuesi ngrihen pretendime për vendimmarrje të padrejtë në vendimin penal nr.94 (2808), datë 06.06.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara, ILD me vendimin nr.2031/2 prot., datë 04.05.2021 ka vendosur arkivimin, duke arsyetuar se *“Mosqenia dakord me një vendimmarrje të prokurorisë apo të gjykatës, nuk përben domosdoshmërisht shkak për fillimin e hetimit disiplinor. Legjislacioni procedural penal dhe civil, parashikon të drejtën e ankimit, si një nga të drejtat themelore procedurale të palëve, të cilat nuk janë dakord me një vendimmarrje të caktuar, duke u drejtuar sipas hierarkisë, gjykatave të rretheve gjyqësore, gjykatave të apelit e më tej Gjykatës së Lartë. Inspektori i Lartë i Drejtësisë gjatë ushtrimit të kompetencave të veta udhëhiqet edhe nga parimi i respektimit të pavarësisë së magjistratit në ushtrimin e detyrës së vet, duke marrë masat për të shmangur çdo lloj perceptimit, si ndërhyrje apo zgjidhje të çështjes konkrete...Për sa më sipër referuar natyrës së pretendimeve të parashtruara, ankesa nuk plotëson kriteret e pranueshmërisë të parashikuar nga neni 120, pika 1, shkronjat “d” dhe “dh” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.*

II- Ankesa e shtetasit G.M., regjistruar pranë Zyrës së ILD me nr.233, datë 21.02.2020 konsiston në pretendimet për vendimmarrje jo të drejtë, në shqyrtimin e kërkesës penale të përfunduar me vendimin nr.51-2017-1776, datë 26.04.2017, në të cilën ankuesi ka qenë në cilësinë e kërkuetit. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës, me vendimin nr.4295/1 prot., datë 14.01.2022, ILD ka vendosur për arkivimin e ankesës për shkak ankesa nuk plotëson kriteret e pranueshmërisë të parashikuara në nenin 120, pika 1 shkronjat “d” dhe “dh” të ligjit nr. 96/2016.

III- Ankesa e shtetasit F.L., regjistruar në ILD me nr. 337 prot., datë 10.02.2022, përmes të cilës, ankuesi ngre pretendime për shkelje të ligjit procedural gjatë shqyrtimit të çështjes penale të përfunduar me vendimin nr.94 (2808), datë 06.06.2018, në të cilën ankuesi ka qenë në cilësinë e kërkuetit. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës me vendimin nr.337/2 prot., datë 31.03.2022, ILD ka vendosur për arkivimin e ankesave për shkak ato nuk plotëson kriteret e pranueshmërisë të parashikuara në shkronjën “c”, pika 1 të neni 120 të ligjit nr. 96/2016.

IV- Në ankesën e shtetasit Z.P., regjistruar pranë Zyrës së ILD me nr.1404 prot, datë 29.06.2020 ngrihen pretendime për vendimmarrje të padrejtë në çështjen penale të përfunduar me vendimin nr.1166, datë 26.06.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës, ILD me vendimin nr.2041/1 prot., datë 16.09.2022 ka vlerësuar se pretendimet zgjidhen mbi bazën e apelimit gjyqësor në rast të ushtrimit të ankimit të vendimit të dhënë dhe për

---

shtetasit M.Q. lidhet, sipas përmbajtjes së tij, me një ankesë të paraqitur për një tjetër magjistrat, konkretisht për magjistraten K.K.

rrjedhje ankese duhet te arkivohet ne zbatim te nenit 120, pika 1, shkronja "d", dhe "dh" te ligjit nr.96/2016.

V- Ne ankesen e shtetases R.N., regjistruar pranë Zyrës së ILD me nr.640 prot, datë 17.03.2022 ngrihen pretendime për veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarit Sokol Shehu, gjatë gjykimit të çështjes civile me objekt "Pjesëtim pasurie", në të cilën ankuesja është në cilësinë e palës paditëse. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës, ILD me vendimin nr.640/3 prot., datë 04.10.2022 ka vlerësuar se pretendimet e ankesës në thelb janë pretendime të cilat lidhem me mënyrën e zgjidhjes së çështjes gjyqësore dhe vlerësimit të provave nga gjykata. Shqyrtimi dhe vlerësimi i pretendimeve të palëve dhe provave gjatë një procesi gjyqësorë, është atribut i pushteti gjyqësor, dhe për rrjedhje ankese në zbatim të nenit 120, pika 1, shkronja "d", dhe "dh" dhe nenit 121, pika 2, shkronja "a" të ligjit nr.96/2016 është arkivuar.

VI- Ankesat e shtetasit F.L., të regjistruara në ILD me nr. 1774 prot., datë 21.06.2022, nr. 3113 prot., datë 08.11.2022, nr. 3113/2 prot., datë 21.12.2022 dhe nr. 3113/3 prot., datë 17.01.2023, pas shqyrtimit fillestar me vendimin nr. 1281 prot., datë 19.04.2023, janë arkivuar nga Inspektori për shkak se nuk plotësojnë kriteret e pranueshmërisë të parashikuara në shkronjën "c", pika 1 të nenit 120 të ligjit nr. 96/2016, pasi paraqesin natyrë përsëritëse, duke qenë të lidhura me ankese të mëparshme të trajtuara dhe të arkivuara nga ILD me vendimin nr. 2031/2 prot., datë 04.05.2021.

VII- Në ankesën e shtetasit G.H., e regjistruar pranë Zyrës së ILD me nr. 261 prot., datë 28.01.2021, janë ngritur pretendime për zvarritje të gjykimit në një çështje civile të përfunduar me vendimin nr. 857 (2745), datë 27.06.2017, si dhe për dorëzimin me vonesë të vendimit të arsyetuar. Pas verifikimit të ankesës, ILD, me vendimin nr. 211/1 prot., datë 20.04.2023, ka vendosur arkivimin e saj. Në arsyetim theksohet se pretendimet e ankuesit lidhur me dorëzimin me vonesë të vendimit nuk qëndrojnë, pasi rezulton se vendimi është dorëzuar brenda afateve të parashikuara nga legjislacioni procedural civil. Ndërkohë, duke marrë parasysh kohën e gjatë të kaluar në lidhje me pretendimet e ngritura, është konkluduar se ekziston shkak që e bën objektivist të pamundur vijimin e verifikimit të mëtejshëm të ankesës, për shkak të parashkrimit të shkeljes disiplinore. Kjo për arsye se pretendimet i referohen fakteve të ndodhura në një çështje civile, e cila ka përfunduar gjykimin më datë 27.06.2017.

VIII- Në ankesën e shtetases Z.P., e regjistruar në ILD me nr. 361, datë 27.02.2020, janë ngritur pretendime ndaj një sërë magistratësh, ndër të cilët edhe ndaj trupës gjyqësore të përbërë nga gjyqtarët B.S., A.Ç. dhe Sokol Shehu, lidhur me dhënien e vendimit penal nr. 116 (3114), datë 26.06.2018. Me vendimin nr. 22/1 prot., datë 15.05.2023, Inspektori ka vendosur arkivimin e ankesës pas shqyrtimit fillestar të saj, duke argumentuar se ankese rezulton të jetë e përsëritur. Konkretisht, të njëjtat pretendime ndaj të njëjtëve magistratë dhe për të njëjtat fakte janë trajtuar më parë dhe është shprehur qëndrim me vendimin nr. 2041/2 prot., datë 16.09.2022. Për rrjedhje, është vlerësuar se ankese nuk përmbush kriteret e pranueshmërisë, referuar nenit 120, pika 1, shkronjat "c" dhe "ç" të ligjit nr. 96/2016.

IX- Në ankesat e shtetasve A.H., V.H. dhe E.H., të regjistruara në ILD me nr. 1305 prot., datë 23.06.2020 dhe nr. 1305/2 prot., datë 08.07.2020, janë ngritur pretendime, ndër të tjera, edhe ndaj trupës gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Dhoma Penale, lidhur me procedurat e ndjekura gjatë gjykimit të çështjes penale ndaj të pandehurit E.H., i akuzuar për

kryerjen e veprës penale të “Vrasjes me paramendim”. Pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara, me vendimin nr. 1251/1 prot., datë 15.05.2023, Inspektori ka arsyetuar se kërkesa nuk është paraqitur në formën e përcaktuar në nenin 120, pika 1, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016. Konkretisht, megjithëse ankesa përmban gjeneralitetet e ankuesve dhe adresat e tyre, si dhe përshkruan rrethanat faktike të pretenduara dhe identifikon institucionet përkatëse (gjykatën dhe prokurorinë), ajo nuk identifikon asnjë magjistrat konkret, qoftë prokuror apo gjyqtar, i cili të ketë ushtruar funksionin përkatës në kohën kur pretendohet se ka ndodhur shkelja. Nga verifikimi i faqes elektronike të Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, rezulton se çështja penale është përfunduar me vendimin nr. 51-2019-984, datë 26.02.2019, të dhënë nga trupa gjyqësore e përbërë nga gjyqtari A.Ç., në cilësinë e kryesuesit, dhe L.D. dhe Sokol Shehu, në cilësinë e anëtarëve. Pretendimet e ankuesve për shkelje, që konsistojnë në faktin se prindërit nuk janë marrë në pyetje nga gjykata, në thelb lidhen me ushtrimin e kompetencave që legjislacioni procedural penal i njuh gjykatave. Trajtimi i pretendimeve për zbatim të gabuar apo mosrespektim të legjislacionit procedural ose material gjatë shqyrtimit gjyqësor është kompetencë e gjykatave më të larta, në kuadër të ushtrimit të mjeteve procedurale të ankimit në gjykatën e apelit dhe rekursit në Gjykatën e Lartë. Për rrjedhojë, është vlerësuar se ankesa nuk plotëson kriteret e pranueshmërisë të parashikuara nga neni 120, pika 1, shkronjat “d” dhe “dh” të ligjit nr. 96/2016.

Sa më sipër, në lidhje me këtë tregues nuk rezultojnë të dhëna, për cenimin e etikës në punë të gjyqtarit subjekt vlerësimi.

Gjyqtari dhe zëvendëskryetari e gjykatës në Formularin e Integruar të Vlerësimit i kanë vlerësuar shumë të larta aftësitë e gjyqtarit në drejtim të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

*Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e etikës së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 35 pikë.*

### **3.B. Integriteti i gjyqtarit**

#### **3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, për periudhën 01.01.2020-31.12.2022, rezulton të jenë regjistruar pranë ILD paraqitur 9 (nëntë) ankesa,<sup>49</sup>

<sup>49</sup> Sipas informacionit të dërguar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me shkresën nr. 436/1 prot., datë 27.02.2025, rezulton se për gjyqtarin subjekt vlerësimi janë paraqitur 10 ankesa, ndërkohë që nga vendimet

për të cilat, pas verifikimit, Inspektor i Lartë i Drejtësisë me vendimet nr.2031/2 prot., datë 04.05.2021, nr. 4295/1 prot, datë 14.01.2022, nr.337/2 prot., datë 31.03.2022, nr.2041/1 prot., datë 16.09.2022, nr.640/3 prot., datë 04.10.2022, nr. 1281 prot., datë 19.04.2023, nr.211/1 prot., datë 20.04.2023, nr.22/1 prot., datë 15.05.2023 dhe nr.1251/1 prot., datë 15.05.2023, në të cilat është vendosur arkivimi pas shqyrtimit fillestar, për shkaqet e referuar në analizën e treguesit më sipër.

Nga tërësia e fakteve të parashtruar dhe të analizuar në vendimet e ILD, nuk rezultojnë të dhëna për cenim të etikës apo elementë të tjerë që ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarit, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Gjithashtu, nuk rezulton që ndaj gjyqtarit Sokol Shehu, gjatë periudhës së vlerësimit të jetë dhënë apo zbatuar ndonjë masë disiplinore.

Referuar raportit të ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr. 241/23 prot., datë 10.04.2025, rezulton se: *“Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr.9049, dt. 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, ligjin nr.9367, dt. 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar dhe ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konstatohet se, për kandidatin Sokol Shehu: a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë; c) nuk ka fshehje të pasurisë; d) nuk ka kryer deklarim të rremë; e) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave”.*

Gjyqtari, lidhur me këtë tregues, e ka vlerësuar aftësinë e tij në nivel shumë të lartë. I njëjti vlerësim është dhënë edhe nga zëvendëskryetari i gjykatës.

#### **KONKLUZIONI**

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të tregojnë për cenim të integritetit të gjyqtarit, gjyqtari pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

***Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtarit në lidhje me treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.*

---

bashkëlidhur shkresës rezulton se vendimi nr. 255/7 prot., datë 13.12.2022 mbi arkivimin e ankesës së shtetasit M.Q. lidhet, sipas përmbajtjes së tij, me një ankesë të paraqitur për një tjetër magistrat, konkretisht për magistraten K.K.

### **3.C. Paanësia e gjyqtarit**

#### ***3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese***

Nga analiza e burimeve të vlerësimit pasqyruar në Raportin Analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të tij. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor, akteve të administruara në dosjet e gjykimit, si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtarit.

Gjyqtari dhe zëvendëskryetari, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtarit në nivel shumë të lartë.

#### **KONKLuzioni**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

*Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

#### ***3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për periudhën e vlerësimit, janë paraqitur 7 (shtatë) kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit, të cilat janë rrëzuar të gjitha. Ndërkohë vetë gjyqtari ka paraqitur 30 (tridhjetë) kërkesa për heqje dorë, të cilat janë pranuar.

#### **KONKLuzioni**

Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, referuar dhënave burimore për ekzistencën e numrit të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit (*asnjë kërkesë e pranuar*), numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit vlerësohet “I pakonsiderueshëm”.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit”, ky numër është “I pakonsiderueshëm”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

#### **4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL**

*Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.*

##### **4.A. Aftësia e komunikimit**

###### **4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtari, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është i qartë, transparent, i kuptueshëm. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarit për të qartësuar kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre.

Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë, koncize, e saktë dhe e kuptueshme, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

Gjyqtari dhe zëvendëskryetari i gjykatës, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtarit në nivel shumë të lartë.

##### **KONKLUZIONI**

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë, koncize dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes të jetë i qartë, i drejtpërdrejtë dhe i kuptueshëm.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

#### **4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk evidentohet asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo të subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

#### **KONKLUZIONI**

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari në çdo rast ka respektuar konfidencialitetin dhe të dhënat personale të palëve duke treguar aftësi të larta në drejtim të këtij treguesi.

*Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “E lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

#### **4.B. Aftësia për të bashkëpunuar**

##### **4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Gjyqtari dhe zëvendëskryetari i gjykatës e kanë vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se gjyqtari ka komunikim etik dhe korrekt. Ai është bashkëpunues në ngritjen dhe diskutimin e problematikave të ndryshme ligjore.

#### **KONKLUZIONI**

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

#### **4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik nuk rezultojnë të dhëna negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, ndërkohë që gjyqtari dhe zëvendëskryetari i gjykatës e kanë vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë, duke parashtruar se gjyqtari ka marrëdhënie dhe komunikim etik, korrekt dhe mirëkuptues me administratën gjyqësore.

#### **KONKLuzioni**

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore është shumë e lartë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

#### **4.C. Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera**

##### **4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtari Sokol Shehu, gjatë periudhës së vlerësimit 01.01.2020-31.12.2022, ka marrë pjesë në cilësinë e pjesëmarrësit në Programin e Formimit Vazhdues në 13 (trembëdhjetë) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë trajnimi.

Për periudhën e vlerësimit nuk rezulton që gjyqtari të ketë marrë pjesë në aktivitetet profesionale jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

#### **KONKLuzioni**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës penale, gjithsej 13 aktivitete të shtrira në 15 ditë trajnimi, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në të gjithë periudhën tre vjeçare.

*Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës është brenda kufijve 15–120 ditë, duke u pikëzuar me 20 pikë.*

#### **4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe dosjes personale të gjyqtarit Sokol Shehu, rezulton se me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.242, datë 30.06.2022 gjyqtari është miratuar si gjyqtar udhëheqës për periudhën 2021-2024, por nuk rezulton që për periudhën e vlerësimit të jenë caktuar pranë tij për mentorim kandidatët për magistratë. Gjithashtu, referuar informacionit të përcjellë prej Shkollës së Magjistraturës nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues së Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e lehtësuesit apo ekspertit.

Në Formuarin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari ka deklaruar se ka shprehur vullnetin për t'u përfshirë në listën e gjyqtarëve udhëheqës për kandidatët për gjyqtarë, por nuk është caktuar asnjë magistrat për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Gjithashtu, ka deklaruar se gjatë viteve 2021 dhe 2022 ka zhvilluar leksione të hapura me studentët e Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, mbi tema të së drejtës procedurale penale. Lidhur me veprimtarinë e parashtruar nga gjyqtari për zhvillimin e leksioneve të hapura, vlerësohet se kjo veprimtari afekton treguesin pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe si e tillë do të merret në analizë në këtë tregues.

Në Metodologjinë e Pikëzimit përcaktohet se me anë të këtij kriteri, Këshilli konsideron vlerë të shtuar për gjyqtarin gatishmërinë e tij për të kontribuar si gjyqtar udhëheqës në praktikën profesionale të kandidatëve për gjyqtarë, dhe/ose si ekspert/lehtësues në trajnimin fillestar apo vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, apo në trajnime të organizuara nga institucione të tjera. Duke marrë parasysh se pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët e fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë të tjera iu shtohen në vlerësim **gjyqtarëve që e kryejnë këtë veprimtari** njëkohësisht me veprimtarinë gjyqësore, pavarësisht nga frekuenca e angazhimit

#### **KONKLUZIONI**

Sa më sipër, ndonëse gjyqtari Sokol Shehu është miratuar si gjyqtar udhëheqës për periudhën 2021-2024, nuk rezulton që për periudhën e vlerësimit të jenë caktuar pranë tij kandidatë për magistratë për mentorim, si dhe nuk rezulton angazhimi e tij në programin e formimit vazhdues së Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e lehtësuesit apo ekspertit.

***Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi:*** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.

#### ***4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata***

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezultojnë të dhëna në lidhje me pjesëmarrjen e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Në Formuarin e Integruar të Vlerësimit, gjyqtari Sokol Shehu ka deklaruar se ka qenë i angazhuar jashtë funksionit në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, duke kontribuar në përmirësimin e programeve të formimit fillestar dhe vazhdues, si dhe duke propozuar tema për trajnimet përkatëse. Gjithashtu, prej vitit 2016 është anëtar i Shoqatës së Gjyqtarëve dhe gjatë viteve 2021–2022 ka zhvilluar leksione të hapura për studentët e Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

Në lidhje me këto veprimtari, gjyqtari ka paraqitur Vërtetimin nr. 890 prot., datë 17.12.2025, të lëshuar nga Fakulteti i Shkencave Politiko-Juridike i këtij universiteti, i cili konfirmon pjesëmarrjen e tij në zhvillimin e leksioneve të hapura me temat: “Pavlefshmëria absolute dhe relative e akteve procedurale”, në vitin akademik 2021–2022, si dhe “Masat e sigurimit personal, revokimi, zëvendësimi dhe shuarja”, në vitin akademik 2022–2023.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, për pikëzimin e këtij treguesi, vlerësohet dedikimi i kohës dhe përpjekjeve të gjyqtarit për përmirësimin e sistemit gjyqësor në mënyra të ndryshme. Këtu përfshihen: fjalimet publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efikasitetit; kontribute në hartimin e legjislacionit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshëm me qëllim rritjen e cilësisë të gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike.

Duke marrë parasysh se pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët e fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë të tjera iu shtohen në vlerësim gjyqtarëve që kryejnë këto veprimtari njëkohësisht me veprimtarinë gjyqësore, duke marrë parasysh sasinë dhe cilësinë e angazhimit, shkallën e pjesëmarrjes së gjyqtarit, ndikimin në veprimtarinë specifike dhe shtrirjen e angazhimit, si dhe çdo e dhënë tjetër që del nga burime vlerësimit të këtij treguesi.

## KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale prandaj pikëzohet me 5 pikë.

*Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues gjyqtari pikëzohet me 5 pikë.*

### 4.C.ç Publikimet ligjore akademike

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtarit në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk rezultojnë të dhëna.

## KONKLUZIONI

Për sa më sipër, në mungesë të të dhënave për këtë tregues, gjyqtari pikëzohet me 0 (zero) pikë.

*Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin "Publikime ligjore akademike" nuk rezulton angazhim i gjyqtarit dhe për këtë shkak pikëzohet me 0 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
93	Shkëlqyeshëm

## NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	93	Shkëlqyeshëm
<b>Niveli i përgjithshëm i vlerësimit</b>		
Vlerësimi i përgjithshëm	393	Shkëlqyeshëm

## **REKOMANDIME**

Bazuar në nenin 93, pika 5, shkronja “ç”, të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuara dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtari Sokol Shehu të mbajë në konsideratë angazhimin e tij në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit në këto fusha.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**